



# KËRKIMI

REVISTA E STATISTIKAVE DHE ANALIZAVE SOCIAL-EKONOMIKE  
INSTAT

---

# EDITORËT

## DREJTOR BOTIMI

Dr. Elsa Dhuli, Instituti i Statistikave

## BORDI EDITORIAL

1. Alban Çela, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
2. Alma Kondi, Instituti i Statistikave
3. Altin Xhikneli, Instituti i Statistikave
4. Blerina Subashi, IDRA
5. Ermir Liço, Instituti i Statistikave
6. Helda Curma, Instituti i Statistikave

## BORDI KËSHILLIMOR

1. Dr. Delina Ibrahimaj, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
2. Prof. Dr. Bukurie Dumani, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Ekonomik
3. Assoc. Prof. Dr. Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranës
4. Dr. Erion Luçi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
5. Dr. Erka Caro, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
6. Dr. Evelina Çeliku, Banka e Shqipërisë
7. Assoc. Prof. Gianluca Mattarocci, Universiteti i Romës Tor Vergata
8. Dr. Sebastian Schief, Universiteti i Fribourg, Departmenti i Shkencave Sociale

ISSN: 2664-1380

Copyright INSTAT 2020

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

\*Pikëpamjet e shprehura në këtë revistë janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Institutit të Statistikave.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

e-mail: [Revistakerkimi@instat.gov.al](mailto:Revistakerkimi@instat.gov.al)

Tel: +(355) 42222411

---

# PËRMBAJTJA

## ARTIKUJ SHKENCORË

5. **VLERËSIMI I ELASTICITETIT TË KËRKESESË NË LIDHJE ME ÇMIMIN DHE TË ARDHURAT PËR MALLRAT LUKSOZE, ME FOKUS “BIRRËN”**  
Aida Gjika, Universiteti i Tiranë dhe CERGE – EI  
Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranë dhe CERGE – EI  
Anisa Omuri, Instituti i Statistikave
  
15. **NJË QASJE E VARIANCËS SË TOTALIT PËR GRUPET HOMOGENE TË PËRGJIGJURA ME METODËN SSRS**  
Kristaq Bollano, Instituti i Statistikave  
Liljana Boçi, Instituti i Statistikave
  
23. **QËNDRUESHMËRIA E BORXHIT PUBLIK RASTI I SHQIPËRISË**  
Elma Çali, Instituti i Statistikave  
Sokrat Palushi, Instituti i Statistikave

## ARTIKUJ INFORMUES

31. **STATISTIKAT E VRASJEVE NË SHQIPËRI**  
Albana Berbiu, Instituti i Statistikave  
Ornela Xhembulla, Prokuroria e Përgjithshme  
Blerina Metanj (Subashi), Instituti i Statistikave
  
41. **ÇMIMET E KONSUMIT NË SHQIPËRI**  
Hazbi Bunguri, Instituti i Statistikave  
Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave  
Jesmina Shahini, Instituti i Statistikave
  
51. **OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM SFIDAT E ZBATIMIT TË AGJENDËS 2030**  
Vjollca Simoni, Instituti i Statistikave
  
59. **SISTEMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR PESHKIMIN NË SHQIPËRI**  
Denis Kristo, Instituti i Statistikave  
MSc. Marco Kule, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



# VLERËSIMI I ELASTICITETIT TË KËRKESËS NË LIDHJE ME ÇMIMIN DHE TË ARDHURAT PËR MALLRAT LUKSOZE, ME FOKUS “BIRRËN”

Aida Gjika, Universiteti i Tiranë dhe CERGE – El  
aida.gjika@gmail.com

Edvin Zhllima, Universiteti Bujqësor i Tiranë dhe CERGE – El  
ezhllima@ubt.edu.al

Anisa Omuri, Instituti i Statistikave  
aomuri@instat.gov.al

## Abstrakt

Përcaktuesit e kërkesës së konsumatorit janë hulumtuar gjerësisht sa i takon aspektit empirik. Hulumtimi mbi produktet që i nënshtrohen akcizës së fundi është në vëmendjen e vendeve të zhvilluara dhe, në një masë më të vogël, në vendet në zhvillim apo tranzicion. Një nga politikatat më të përdorura për të përmirësuar të ardhurat konsumatore është përdorimi i akcizës, e cila përdoret në disa lloje të produkteve të tilla si alkooli, kafeja dhe duhani. Rezultatet në të gjitha vendet me nivele ekonomike të ndryshme sugjerojnë se rritja e akcizës së duhanit është një politikë efektive nëse merret në konsideratë elasticiteti i kërkesës. Pavarësisht ndryshimeve të shpeshta të regjimit të akcizës në Shqipëri, vihet re mungesa e një studimi empirik mbi elasticitetin e çmimeve të mallrave të luksit.

Ky studim, i motivuar nga nevoja për të hulumtuar kërkesën mbi mallrat e luksit në Shqipëri, nga të cilat politikatat fiskale mund të përshtaten më mirë dhe nga mungesa e studimeve empirike, bazohet gjerësisht në analizën ekonometrike të të dhënave në nivel mikro të familjeve shqiptare. Ky artikull analizon të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes (ABF) në vitet 2014-2017.

Duke ndjekur modelin e kërkesës së Deaton (1988) dhe duke përdorur të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjes, ky studim vlerëson elasticitetin e çmimit për kërkesën e mallrave të luksit, i cili në njohuritë tona përbën studimin e parë empirik të kryer në Shqipëri me varietet produktesh. Më saktësisht, ky studim vlerëson një sistem pothuajse ideal të kërkesës (AIDS), i cili lejon ndarjen e efektit të ndryshimit të cilësisë nga ndryshimet ekzogjene të çmimeve përmes përdorimit të vlerave njësi nga konsumi i mallrave të luksit. Për sa i përket variablave, shpenzimet totale, madhësia e familjes, raporti burra/gra dhe raporti i të rriturve janë përcaktues të rëndësishëm të kërkesës për mallra luksi në Shqipëri.

## Fjalë kyçe:

Elasticitet i kërkesës; Modeli Deaton; Të dhëna mikro

## 1. HYRJJE

Ndërsa rishikimi i literaturës identifikon gjerësisht përcaktuesit e kërkesës për një produkt të caktuar, është lënë disi pas dore fokusi në produktet që i nënshtrohen akcizës. Me përjashtim të duhanit, produkte të tjera si pijet alkoolike, kafeja, vera dhe pijet energjetike mbeten nën studim nga një terren empirik. Të gjitha këto mallra janë të rëndësishme për t'u studiuar në kontekstin e Shqipërisë, por ky studim do të përqendrohet tek birra, pije e cila i nënshtrohet taksës së akcizës dhe shoqërohet me efekte negative në shëndet. Në përgjithësi, efektet e konsumit të alkoolit theksohen nga shumë studime kërkimore, por jo karakteristikat e kërkesës së tij. Konsumi i tepërt i alkoolit është i lidhur me rritjen e rrezikut të cerozës së mëlçisë, sëmundjeve kardiovaskulare dhe sëmundjeve të tjera (Rehm, et al., 2003; 2004) [30], [31]).

Si pasojë, konsumi i alkoolit dhe efektet e tij paraqesin një shqetësim kryesor social dhe politik në vendet që karakterizohen nga një nivel i lartë i konsumit të alkoolit.

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE) kanë raportuar konsumin më të lartë të alkoolit për frymë (Popova et al, 2007, [28]; Burazeri dhe Kark, 2010, [6]). Kjo prirje është vërejtur edhe në Shqipëri, e cila ndodhet në Evropën Juglindore, por ka karakteristika të ngjashme socio-ekonomike me vendet e tjera post-komuniste të Evropës Qendrore, ku në dy dekadat e fundit vërehet një nivel në rritje i konsumit të alkoolit (Burazeri dhe Kark, 2010, [6]).

Konsumi i lartë i alkoolit mund t'i atribuohet faktorëve të ndryshëm. Swinnen and Colen (2014, [33]) tregojnë se marrëdhënia midis të ardhurave dhe konsumit të birrës ka një prirje inverse të formës së kurbës së kërkesës (formën e germës U). Zgjerimi i tregut ndërkombëtar, kushtet klimatike, përkatësia fetare dhe çmimet relative janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në kërkesën e birrës, gjithashtu pjesën e birrës në konsumin e përgjithshëm të alkoolit (**ibid**).

Literatura siguron informacione të gjera që dëshmojnë se konsumi i tepërt i pijeve alkoolike adresohen në mënyrë efektive nga një larmi politikash për uljen e kërkesës, duke qenë se ato i nënshtrohen trajtimeve fiskale në formën e taksave (Cawley and Ruhm, 2012, [7]) ose ndërhyrjeve jo-fiskale siç janë kufizimet, fushatat arsimore, gjobat etj. (Nelson, 2003, [27]). Sidoqoftë, ekzistojnë faktorë që ndikojnë në efektin e duhur të mjeteve fiskale siç janë ato që lidhen me elasticitetin (ose joelasticitetin) e kërkesës për pije alkoolike. Ka fakte që tregojnë se elasticiteti i

çmimit të kërkesës për konsumatorët e pijeve alkoolike është i lartë, madje edhe nga pijet e rënda (Xu dhe Chaloupka, 2011, [37]). Megjithatë, studiues të tjerë, në disa raste, kanë mbledhur prova për një kërkesë joelastike për birrë, veçanërisht nga përdoruesit e rëndë (Ayyagari et al. 2011, [1]; Ruhm et al. 2012, [7]).

Pavarësisht shqetësimeve që lidhen me konsumin e pijeve alkoolike në Shqipëri, ekziston një hendek hulumtimi mbi faktorët që përcaktojnë konsumin e alkoolit në përgjithësi, dhe për birrën në mënyrë specifike, e cila është e rëndësishme jo vetëm për industrinë, por edhe për politikëbërësit. Qëllimi i këtij artikulli është të vlerësojë elasticitetin e kërkesës për birrë dhe të sigurojë evidenca për llojin e koeficientit të elasticitetit, të grupuar sipas llojit të birrës, si dhe të të ardhurave. Një kërkesë shumë joelastike ose elastike për birrë mund të sjellë pasojë të rëndësishme për politikën fiskale të lidhur me alkoolin në Shqipëri. Politikat efikase, me qëllim uljen e konsumit të pijeve alkoolike, duhet të bazohen në prova; kuptimi i duhur i elasticitetit të kërkesës së konsumatorit për birrë mund të orientojë politika fiskale efikase.

## 2. RISHIKIMI I LITERATURËS DHE PREJARDHJA E VENDIT

Industria e birrës është një nga industritë më të vjetra në Shqipëri e cila daton prej fillimit të viteve 1900, e përqendruar në Korçë (ndodhet në juglindje të Shqipërisë). Gjatë planifikimit qendror të ekonomisë, sektori vazhdoi të zgjerohet me investimet e bëra në vitet 1960 dhe krijimin e fabrikës së birrës në Tiranë. Me kalimin nga ekonomia e centralizuar në një ekonomi të tregut, në Shqipëri u krijuan më shumë se 30 njësi prodhimi të birrës (MARD, 2016, [24]).

Kohët e fundit, numri i prodhuesve të birrës është pakësuar, shoqëruar me një rritje të madhësisë së firmës. Në vitet e fundit industria e birrës është e pranishme me 14 kompani dhe me qarkullim vjetor prej më shumë se 100 milionë Euro në vit. Ndër birrat lokale dominuese në treg janë Tirana, Korça dhe Stela.

Në përgjithësi, vlera e investimeve është rritur me kalimin e viteve, pas kërkesës në rritje të tregut dhe preferencës ndaj markave vendase (Chan-Halbrendt & Fantle-Lepczyk, 2013, [10]). Vlera e investimeve vjetore është rritur nga 50 milionë euro në 80 milionë euro në vitin 2018.

Politika mbi akcizat në Shqipëri është udhëhequr kryesisht nga lobimi i **proteksionizmit/mbrojtjes**, (Deklarata e Shoqatës Shqiptare të Prodhuesve të Birrës në Dita,

2016, [14]). Prej vitit 2013, në Shqipëri është aplikuar një sistem akcizash me dy nivele. Fabrikat që prodhojnë më pak se 200,000 hektolitra paguajnë një akcizë prej 14 lekësh për litër, ndërsa ata që prodhojnë mbi këtë kufi paguajnë 32 lekë për litër, pra, dallimi është i madh. Në këtë mënyrë, prodhimi vendas ruhet nga importet, në të cilat mbizotërojnë markat të mirëvendosura, gjerësisht prodhuesit e mëdhenj<sup>1</sup>. Sidoqoftë, birra e importuar në Shqipëri është e pranishme në treg dhe veçanërisht birra nga Kosova ka përfituar nga taksat e ulta të akcizës (p. sh. nga prodhuesit që prodhojnë më pak se 200 mijë hektolitra).

Konsumimi i alkoolit në Shqipëri është dominuar tradicionalisht nga Rakia (Chan et al, 2016, [9], Zhllima et al, 2012, [36]). Rakia (raki si Grapa), përdoret gjerësisht si një zëvendësues më pak i shtrenjtë i verës ose birrës, dhe zakonisht prodhohet nga familjet (veçanërisht në zonat rurale) për vetëkonsum. Sidoqoftë, rritja e nivelit të të ardhurave dhe ndryshimi i stilit të jetesës po largon konsumin e rakisë në alternativa të tjera, veçanërisht verën (Skreli dhe Imami, 2019, [32]); rakia nuk është aq e popullarizuar në mesin e brezit të ri siç është vera apo birra. Në të vërtetë, oferta (proxy për konsum) e birrës në Shqipëri është rritur më shumë se 8,0 % që nga viti 2012, siç shihet në tabelën 1.

Oferta e birrës për frymë (e cila përdoret gjerësisht si një proxy për konsum, raportuar në tabelën 1) është afërsisht 38 litra për frymë në vit, ku konsiderohet e gjithë popullsia, dhe më shumë se 50 litra për frymë në vit, ku konsiderohen vetëm të rriturit. Gjatë dekadës së fundit, për shkak të preferencave të konsumatorit dhe ndryshimeve të sjelljes, vërehet një zgjerim i tregut të birrës. Në të vërtetë, birrat më të shtrenjta në treg janë marka të importuara, me reputacion. Për më tepër, disa lloje të birrave, të tilla si birra jo-alkoolike (p.sh. që konsumohet zakonisht nga muslimanët praktikues) importohen ekskluzivisht dhe nuk prodhohen në Shqipëri.

**Tabela 1: Prodhimi dhe oferta e birrës në Shqipëri (ton)**

Kategoria	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Prodhim	77.203	79.519	79.500	89.162	86.203	88.541
Import	23.644	22.035	19.786	19.951	22.380	20.813
Eksport			20,29	3,42	14,5	7,6
Furnizim	100.847	101.554	99.266	109.109	108.568	109.347

Burimi: FAOSTAT dhe UNCOMTRADE, 2019

Alkooli, përfshirë konsumin e birrës, ndikohet nga disa faktorë, kryesisht çmimet dhe të ardhurat. Shumë studime kanë analizuar kërkesën për birrë (Freeman, 2001, [17]; Bray et al., 2009, [4], Toro-González et al, 2014, [34]), me fokus të veçantë në çmimin dhe elasticitetin e të ardhurave

për alkoolin nga perspektiva mikroekonomike. Në mënyrë të ngjashme, metodologjia e ndjekur në këtë studim bazohet në një qasje sasiore për të vlerësuar në mënyrë empirike elasticitetin e çmimeve dhe elasticitetin e të ardhurave të konsumit të alkoolit. Prandaj, autorët zgjedhën modelin e Deaton 1988, [12] i cili vlerëson një sistem pothuajse ideal të kërkesës (AIDS). AIDS u prezantua nga Deaton dhe Muellbauer 1980, [11] dhe Deaton 1997, [13] dhe u aplikua shpesh për të vlerësuar kërkesën për produkte të ndryshme, përfshirë birrën (Clements and Johnson, 1983, [5]; Heien and Pompelli, 1989, [20]; Blake dhe Nied, 1997, [3]; Toro-González et al., 2014, [34]). E njëjta metodologji është përdorur edhe nga autorët për të vrojtuar elasticitetin e çmimeve e të kërkesës për duhan në Shqipëri (Rama et al., 2019, [29]).

Shumica e studimeve empirike kanë zbuluar se koeficientët e elasticitetit të çmimeve janë në përputhje me parashikimet e teorisë. Kështu, elasticiteti i çmimit është gjetur negativ dhe elasticiteti i ndër-çmimit pozitiv; të dy të vegjël (shih Gallet dhe List, 1998 [18], Tremblay dhe Tremblay 2005 [35], Fogarty, 2010 [16]; Nelson, 2014 [26]).

Rreth 191 studime kanë vlerësuar elasticitetin e çmimit të kërkesës për birrë sipas Nelson në 2014, [26]. Autori raportoi meta-analizën e Gallet (2007), [19], Fogarty 2010, [16], dhe rezultatet e tij të meta-analizës, dhe zbuloi se koeficientët e elasticitetit mesatar të papeshuar janë rreth -0.30 deri në -0.50, ndërsa koeficientët e elasticitetit të të ardhurave të papeshuar janë më pak se 0.50 për gjetjet e Gallet 2007, [19] dhe midis 0.50 deri 0.70 në gjetjet Fogarty 2010, [16] dhe Nelson 2014, [26]. Autori zbuloi një elasticitet mesatar çmimi të birrës që është -0.20, i cila është rreth 50,0 % më pak elastik se vlerat e raportuara më parë (ibid). Më herët, në rishikimin e vitit 2009, Fogarty 2006, [15] identifikoi elasticitete edhe më të larta të çmimeve bazuar në një përmbledhje të 46 studimeve.

### 3. METODOLOGJIA

Për të vlerësuar çmimin dhe elasticitetin e të ardhurave për alkoolin, ky studim përdor Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF) për vitin 2014. Ky studim është përfaqësues në nivel kombëtar pasi mbulon 6565 NjEF në të gjitha rajonet (qarqet) në Shqipëri. Baza teorike e modelit konsiston në vlerësimin e funksioneve të kërkesës agregate të produkteve me attribute të pakontrollueshme, siç përshkruhet nga Berry (1994, [2]). Teoria thekson faktin se preferencat e konsumatorëve janë paraqitur nga një funksion i tërthortë i shërbimeve, që varen nga atributet e vëzhguara, si dhe karakteristikave socio-ekonomike të

1. <http://www.gazetadita.al/gjunjezimi-i-birres-made-in-albania/>

konsumatorit. Më konkretisht, modeli i Deaton (1988, [12]), i njohur gjithashtu si modeli Deaton, është një model i sjelljes së konsumatorit i cili në vend të çmimeve përdor vlerat njësi (raporti i shpenzimeve për një të mirë të caktuar mbi sasinë e tij të konsumuar) si një proxy i çmimit. Ky model vlerëson dy ekuacionet si më poshtë:

$$w_{hc} = \alpha^0 + \beta^0 \ln x_{hc} + \gamma^0 \cdot z_{hc} + \theta \ln p_c + u_{ch}^0 \quad (1)$$

$$\ln v_{hc} = \alpha^1 + \beta^1 \ln x_{hc} + \gamma^1 \cdot z_{hc} + \psi \ln p_c + u_{hc}^1 \quad (2)$$

Ku  $h$  dhe  $c$  tregojnë përkatësisht familjen dhe grupin rajonal. Në ekuacionin (1), ndryshorja e varur  $w$  përfaqëson pjesën e konsumit të alkoolit në familje në përqindje, ndërsa  $v$  në ekuacionin (2) tregon vlerat sasiore të alkoolit. Sa i përket variablave të kontrollit,  $x$ ,  $z$  dhe  $p$  paraqesin përkatësisht shpenzimet e familjeve, karakteristikat e tjera të familjeve dhe çmimin e alkoolit. Së fundmi,  $u_{ch}^0$  dhe  $u_{hc}^1$  përfaqëson termat e gabimit.

Pas vlerësimit të ekuacioneve të mësipërme, modeli Deaton sugjeron heqjen e efektit të variablave të kontrollit nga vlerësimet e elasticitetit në fazën e parë. Si rezultat, vlerësohet elasticiteti i çmimit dhe elasticiteti i të ardhurave për birrën. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh llojshmërinë e madhe të birrës, ky studim vlerësoi elasticitetin e mësipërm si subjekt i llojit të birrës. Më konkretisht, duke pasur parasysh klasifikimin e birrës në ABF, ekzistojnë katër lloje të elasticitetit të vlerësuar: (i) lloji i birrës I i cili përfshin birrë me përqindje të lartë alkooli, (*birrë1*), (ii) lloji i birrës II që përfshin birrë tjetër alkoolike (*birrë2*), (iii) lloji i birrës III që tregon birra me nivele të ulta alkooli dhe joalkoolike (*birrë3*), (iv) lloji IV i cili tregon të gjitha pijet e tjera me bazë birre (*birrë4*). Përveç kësaj, ky studim vlerëson çmimet dhe elasticitetin e të ardhurave për të gjitha llojet e birrës, pa bërë dallimin mes llojeve të ndryshme të birrës.

Një shënim për t'u pasur në konsideratë lidhet me vlerësimin e elasticitetit të çmimit dhe të të ardhurave të alkoolit. Duke pasur parasysh që disa familje nuk pijnë alkool, sjellja e tyre në të vërtetë është e ndryshme nga ato që pijnë (megjithëse analiza përfshin edhe birra joalkoolike, të cilat mund të konsumohen nga një kategori e tillë). Kështu që, gjatë vlerësimit të elasticitetit të mësipërm, ky studim merr parasysh vetëm familjet që raportojnë sasi pozitive të konsumit të alkoolit në mënyrë që të mos devijohet (nën/mbivlerësojnë) çmimi i alkoolit dhe elasticiteti i të ardhurave.

## 4. REZULTATET

Para interpretimit të rezultateve të birrës jepen disa statistika përshkruese për të parë trendet e mallrave të tjerë të konsumit dhe trendin e tyre me kalimin e kohës, siç raportohet nga ABF. Tabela 2 tregon statistikat përshkruese.

**Tabela 2: Statistikat përshkruese të mallrave që i nënshtrohen akcizës**

Lloji i mallit	Numri i vëzhgimeve	Mesatarja
Kafe	26.090	0,831
Kafe e shpejt	7.891	0,110
Cigare	14.692	11,874
Puro	7.574	0,111

*Burimi: Anketat e Buxhetit të Familjes*

Siç vërehet në tabelën 2, pothuajse të gjitha familjet raportojnë konsumin e kafesë. Më konkretisht, 26.090 nga 28.748 NjEF raportojnë një konsum pozitiv. Për më tepër, është raportuar konsumi i llojeve të tjera të kafesë, megjithëse në një masë më të vogël. Rreth 7.891 NjEF raportojnë se konsumojnë kafe të shpejta. Nga ana tjetër, rreth 14.692 NjEF raportojnë konsum pozitiv të cigareve, ndërkohë vetëm 7.574 familje raportojnë se konsumojnë puro.

Meqenëse birra është dhe fokusi kryesor i këtij studimi, siç tregohet në tabelën 3, duhet të theksohet se shenjat e koeficientëve të regresionit janë ashtu siç pritëshin. Shenja e koeficientit negativ mbështet lidhjen e zhdrejtë midis konsumit të birrës dhe çmimit, dhe është në përputhje me të gjitha specifikimet. Çmimi i elasticitetit të birrës është zakonisht më i ulët se 1, duke treguar një kërkesë joelastike të birrës. Madhësia e koeficientit të elasticitetit të çmimit të kërkesës për birrë me përqindje të lartë alkooli është e ngjashme me gjetjet e Nelson (2014, [26]), një vlerë koeficienti -0.4 që tregon se një rritje prej 10,0 % e çmimit të birrës do të shoqërohet me një ulje prej 4,0 % të sasisë së birrës së kërkuar. Sidoqoftë, rezultatet nuk janë domethënëse për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve.

Elasticiteti i çmimit të kërkesës për llojet e tjera të birrave, përveç pijeve joalkoolike dhe pijeve me bazë birre, është gati në -1, që tregon një kërkesë paksa elastike. Kjo do të thotë që një rritje prej 10,0 % e akcizës për birrën do të sillte një efekt negativ gati të barabartë të konsumit të birrës. Ky rezultat ndryshon nga gjetjet në vende të tjera, siç përmendet nga Gallet dhe Lista (1998, [18]); Tremblay dhe Tremblay (2005, [35]); Fogarty (2010, [16]) dhe Nelson (2014, [26]). Për më tepër, nëse të gjitha llojet e birrës konsiderohen si një produkt, elasticiteti i kërkesës



është shumë i lartë, më shumë se 2. Kjo do të thotë se një rritje me 10,0 % të nivelit të çmimit, do të zvogëlonte kërkesën e birrës me më shumë se 20,0 %. Duke pasur parasysh numrin e madh të vëzhgimeve për llojin II të birrës (birrë2), ky studim thekson më shumë rezultatet për këtë lloj birre sesa për llojet e tjera.

**Tabela 3: Elasticiteti i çmimit dhe elasticitetit i të ardhurave për birrë sipas llojit të birrës**

Lloji i birrës	Numri i vëzhgimeve	Elasticiteti i çmimeve	Elasticiteti i të ardhurave
Birrë më e madhe (birrë1)	8.603	-0,55 ***	0,089 ***
Birrë tjetër alkoolike (birrë2)	2.656	-0,957 *	0,159 **
Birrë me nivel të ulët dhe jo alkoolike (birrë3)	8.661	-0,565 ***	0,086 ***
Pije me bazë birre (birrë4)	8.265	-0,018 *	0,358 ***
Çdo lloj birre (birrë)	11.339	-2,175 **	1,363 ***

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Shënim 1: Numër i ulët i vëzhgimeve

Shënim 2: \*\*\* 1% niveli i besueshmërisë

\*\* 5% niveli i besueshmërisë

\* 10% niveli i besueshmërisë

Modeli tregon se elasticiteti i të ardhurave për birrë me përqindje të lartë alkooli është pozitiv, duke përcaktuar birrën si një e mirë normale. Elasticiteti i të ardhurave të kërkesës është 0,016. Kjo do të thotë që një rritje me 10,0 % e të ardhurave të konsumatorëve do të rrisë sasinë e kërkuar me 1.6 %. Kjo është e ngjashme me gjetjet e Fogarty (2010, [16]) për sa i përket shenjës së koeficientit dhe në kundërshtim me Gallet dhe List (1998, [18]). Për më tepër, koeficienti i elasticitetit të kërkesës së të ardhurave është shumë i ulët në krahasim me mesataret e mbledhura nga Fogarty (2010, [16]), midis 0.35 dhe 0.90 për shumicën e vendeve të vëzhguara. Megjithatë, elasticiteti i të ardhurave për të gjitha llojet e birrave të marra së bashku është 1.3 që do të thotë se një rritje prej 10,0 % e të ardhurave të konsumatorëve do të shoqërohej me një rritje prej 13,0 % të kërkesës për birrë. Koeficienti është shumë i lartë në krahasim me të dhënat ndërkombëtare të parashikuara në studimin e Nelson (2014, [26]).

Sa i përket variablave të kontrollit që ndikojnë në vlerat e njësive dhe pjesën e konsumit për alkool, rezultatet e vlerësuar nga regresioni i fazës së dytë ndryshojnë për llojet e ndryshme të birrave, përveç shpenzimeve totale të familjes. Më konkretisht, rezultatet sugjerojnë që në të gjitha llojet e birrave (birrë1, birrë2, birrë3, birrë4 dhe birrë), familjet me një nivel më të lartë të shpenzimeve harxhojnë një pjesë më të ulët të buxhetit të tyre për alkoolin, ndërsa vlerat e njësive janë më të larta në familjet me një nivel mesatar shpenzimesh. Për më tepër, rezultatet, megjithëse nuk janë konsistente kur kalojmë nëpër lloje të ndryshme të birrës, sugjerojnë që pjesa e buxhetit për pije alkoolike është më e madhe në

familjet me më shumë burra, mjete më të larta arsimore dhe më e ulët në familjet me nivel të lartë arsimor (shiko Shtojcën A1).

## 5. KONKLUZIONET

Analiza empirike e kryer në këtë studim analizoi sjelljen e konsumit të birrës ndaj çmimeve dhe ndryshimeve të të ardhurave në vitin 2014 në Shqipëri. Më konkretisht, objektivat kanë të bëjnë me vlerësimin e elasticitetit të çmimeve dhe elasticitetin e të ardhurave të kërkesës për birrë, dhe të ofrojnë disa rekomandime politike lidhur me reagueshmërinë e konsumit të birrës ndaj ndryshimeve të çmimeve dhe të ardhurave. Duke përdorur AIDS në të dhënat vjetore të ABF 2014 -2017, rezultatet e vlerësuar sugjerojnë që elasticiteti i përlogaritur i çmimit në Shqipëri është brenda intervalit të pritshëm në literaturë. Sidoqoftë, koeficienti është shumë më i lartë nëse konsiderohen të gjitha birrat së bashku. Për më tepër, duke marrë parasysh elasticitetin e çmimit të ulët në lidhje me të ardhurat, rezultoi se të ardhurat nuk janë një faktor shumë i rëndësishëm që përcakton konsumin e birrës. Rezultatet ndryshojnë në rast se birrat nuk ndahen sipas llojit, duke sjellë kështu në vëmendje efektet e të ardhurave për kërkesën e birrës.

NjëEF me një nivel më të lartë të shpenzimeve harxhojnë një pjesë më të ulët të buxhetit të tyre për alkool ndërsa regjistrojnë një sasi të lartë të birrës së konsumuar, të vlerësuar në ABF si vlerë njësi. Për më tepër, për një lloj birre, ka një pjesë të konsiderueshme më të lartë të buxhetit tek familjet me më shumë burra, mjete më të larta arsimore. Një pjesë e ulët e buxhetit e shpenzuar për birrë zbulohet tek familjet me nivel të lartë arsimit.

Gjetjet e studimit ndikojnë në hartimin e politikave fiskale. Në të vërtetë, regjimi i akcizës për birrën është bazuar në arsyetime të shumta, të drejtuara shpesh nga forcat e lobimit për të rritur mbrojtjen, sesa shqetësimeve shëndetësore apo buxhetore. Ekziston nevoja për të rishqyrtuar një politikë tatimore bazuar në evidencat e elasticitetit dhe për të diskutuar opsionet dhe arsyetimet kryesore të politikës tatimore. Modeli i regjimit të akcizave duhet të reflektojë sjelljen e konsumatorit, gjerësisht elasticitetin e çmimit të konsumatorit; në përgjithësi ka hapësirë për të rritur akcizën, veçanërisht për kategoritë e birrës që karakterizohen nga elasticiteti më i ulët i çmimeve, i cili mund të ketë ndikime pozitive shëndetësore dhe buxhetore.

Studimi ka kufizime të ndryshme. Vëzhgimet bazohen vetëm në një vit, studimet e ardhshme do të shtrihen edhe në vitet e tjera të mbuluara nga ABF-ja. Modeli

nuk ka analizuar për sjelljet e konsumatorëve, duke mos siguruar elasticitetin e kërkesës për pije me përçindje të lartë alkoolike (siç bëhet në Xu dhe Chaloupka, 2011, [37]). Për më tepër, modeli nuk kontrollon efektin e elasticitetit të kryqëzuar me llojet e tjera të produkteve alkoolike. Opsionet zëvendësuese mund të sjellin prova shtesë dhe plotësuese, të cilat janë me interes të rëndësishëm për politikëbërësit në fushën e politikave fiskale dhe shëndetësore.

## BIBLIOGRAFIA

- [1] Ayyagari, P., Deb, P., Fletcher, J., Gallo, W., Sindelar, J.L., 2011. *Understanding heterogeneity in price elasticities in the demand for alcohol for older individuals*. Health Economics 22, 89-105.
- [2] Berry, S.T. (1994). "Estimating Discrete-Choice Models of Product Differentiation." RAND Journal of Economics 25:242-262.
- [3] Blake, D. & Nied, A. (1997). "The Demand for Alcohol in the United Kingdom." Applied Economics 29:1655-1672.
- [4] Bray, J. W., B. R. Loomis, and M. Engelen. "You Save Money When You Buy in Bulk: Does Volume-Based Pricing Cause People to Buy More Beer?" Health Economics 18(2009):607-618.
- [5] Clements, K.W. & Johnson, L. W. (1983). "The Demand for Beer, Wine, and Spirits: A System-Wide Analysis." The Journal of Business 56:273-304.
- [6] Burazeri, G. & Kark, J. D. (2010). *Alcohol intake and its correlates in a transitional predominantly Muslim population in southeastern Europe*. Addictive behaviors, 35(7), 706-713.
- [7] Cawley, J. & Ruhm, C.J. (2012). *The economics of risky health behaviors*. In: M.V. Pauly et al. (Eds), Handbook of health economics, vol. 2. North-Holland: Oxford. pp. 95-199.
- [8] Cook, P.J. (2007). *Paying the tab – The costs and benefits of alcohol control*. Princeton: Princeton University Press.
- [9] Chan, C., Bytyqi, Nj., Merkaj, E., Imami, D. & Zhllima, E. (2016). *Emerging consumer preference for wine attributes in urban Kosovo – a post-conflict country*, International Food Marketing Research Symposium, Bologna, Italy, June 13-14, 2016
- [10] Chan-Halbrendt, C. & Fantle-Lepczyk, J. (2013). *Agricultural markets in a transitioning economy -The Albanian case study*. Wallingford: CABI.
- [11] Deaton, A. & J. Muellbauer, J. (1980). "An Almost Ideal Demand System." American Economic Review, 70:312-326.
- [12] Deaton, A. (1988). *Quality, quantity, and spatial variation of price*. American Economic Review 78(3), 418-430.
- [13] Deaton, A. (1997), 'The analysis of household surveys: a microeconomic approach to development policy', Washington, D.C. : The World Bank. <http://documents.worldbank.org/curated/en/593871468777303>
- [14] Dita (Journal). 2016. *Gjunjëzimi i birrës "Made in Albania"*, available at: <http://www.gazetadita.al/gjunjEZimi-i-birres-made-in-albania/>, last visited May, 2019.
- [15] Fogarty, J. (2006). *The nature of the demand for alcohol: understanding elasticity*, British Food Journal, Vol. 108 Iss: 4 pp. 316 – 332
- [16] Fogarty, J. (2010). *The demand for beer, wine and spirits: a survey of the literature*. Journal of Economic Surveys 24, 428-78.
- [17] Freeman, D. G. "Beer and the Business Cycle." Applied Economics Letters 8(2001):51-54.
- [18] Gallet, C. A. & List, J. *Elasticities of beer demand revisited*, Economics Letters, 1998, vol. 61, issue 1, 67-71.
- [19] Gallet, C.A. *The demand for alcohol: a meta-analysis of elasticities*. The Australian Journal of Agricultural and Resource Economics, Volume 51, Issue2, June 2007, 121-135.
- [20] Heien, D. & Pompelli, G. (1989). "The Demand for Alcoholic Beverages: Economic and Demographic Effects." Southern Economic Journal 55:759-770.

- [21] Kume, V. (2011). *Shembuj studimore nga bizneset shqiptare*. Tirane: Pegi Publishing House.
- [22] Levy, D. & Sheflin, N. (1985). “*The Demand for Alcoholic Beverages: An Aggregate Time-Series Analysis.*” *Journal of Public Policy & Marketing* 4:47-54.
- [23] Mamillo, D. (2015). *Supply Chain Collaboration under Uncertainty in the Albanian Beer Market, Management Dynamics in the Knowledge Economy*, Vol. 3 (2015)
- [24] MARD (Ministry of Agriculture and Rural Development). (2016). *Data from the agroprocessing industry survey, Report to the 8th European Union – Albania sub-committee meeting on Agriculture and Fisheries*
- [25] MARD . (2018). *Data from the agroprocessing industry survey, Report to the 10th European Union – Albania sub-committee meeting on Agriculture and Fisheries*
- [26] Nelson, J. P. (2014). *Estimating the price elasticity of beer: Meta-analysis of data with heterogeneity, dependence, and publication bias*. *Journal of Health Economics*, 33, 180-187.
- [27] Nelson, J. P. (2003). «*Advertising bans, monopoly, and alcohol demand: testing for substitution effects using state panel data.*» *Review of Industrial Organization* 22, no. 1 (2003): 1-25.
- [28] Popova, S., Rehm, J., Patra, J. & Zatonski, W. (2007). *Comparing alcohol consumption in central and eastern Europe to other European countries*. *Alcohol & Alcoholism*, 42, 465–473.
- [29] Rama, K., Gjika, A., Zhllima, E. & Imami, D. (2019). *Elasticity of Tobacco Products in Albania using macro data*, available at: <http://tobaccotaxation.org/wp-content/uploads/2019/02/National-study-Albania-2.pdf>, last visited May 2019.
- [30]. Rehm, J., Room, R., & Monteiro, M. (2004). Alcohol use. In M. Ezzati, A.D. Lopez, A. Rodgers, & C. J. L.Murray (Eds.), *Comparative quantification of health risks: Global and regional burden of disease attributable to selected major risk factors*, Vol. 1. (pp. 959–1109) Geneva: World Health Organization.
- [31] Rehm, J., Room, R., Monteiro, M., Gmel, G., Graham, K., Rehn, N., Sempos, C.T. & Jernigan, D. (2003). *Alcohol as a risk factor for global burden of disease*. *European Addiction Research*, 9, 157–164.
- [32] Skreli, E. & Imami, D. (2019). *Wine sector study*, Technical report prepared for EBRD
- [33] Swinnen, J. FM. & Liesbeth, C. (2014). *Beer Drinking Nations: The Determinants of Global Beer Consumption*. No. id: 4324. 2011.
- [34] Toro-González, D., McCluskey, J. J. & Mittelhammer, R. C. (2014). *Beer Snobs Do Exist: Estimation of Beer Demand by Type* (No. 169787). Agricultural and Applied Economics Association.
- [35] Tremblay, V. J., & Tremblay, C. H. (2005). *The US brewing industry: data and economic analysis*. MIT Press.
- [36] Zhllima, E., Chan-Halbrendt, C., Zhang, Q., Imami, D., Long, R., Leonetti, L., & Canavari, M. (2012). *Latent class analysis of consumer preferences for wine in Tirana, Albania*. *Journal of international food & agribusiness marketing*, 24(4), 321-338.
- [37] Xu X., Chaloupka FJ. (2011). *The effects of prices on alcohol use and its consequences*. *Alcohol Res Health*; 34(2), 236-45.

## 1. SHTOJCË

### A1. Summary Statistics

```
. sum quantitymonthly_coffee quantitymonthly_coffee_instant
quantitymonthly_cigarettes quantitymonthly_cigars quantitymonthly_tobacco
quantitymonthly_beer1
> quantitymonthly_beer2 quantitymonthly_beer3 quantitymonthly_beer4
```

Variable	Obs	Mean	Std. Dev.	Min	Max
quantitymo~e	26,090	.83199	5.203184	0	685.014
quantitymo~t	7,891	.1100564	4.829191	0	428
quantitym~es	14,692	11.87436	13.45547	0	113.42
quantitym~rs	7,574	.1116055	2.773894	0	192.6
quantitymo~o	7,519	0	0	0	0
quantitymo~1	8,603	1.009295	3.026552	0	50.29
quantitymo~2	2,656	6.642396	5.93646	.535	56.282
quantitymo~3	8,661	1.084185	12.08793	0	1094.61
quantitymo~4	8,265	.6211308	2.228277	0	40.66



# NJË QASJE E VARIANCËS SË TOTALIT PËR GRUPET HOMOGENE TË PËRGJIGJURA ME METODËN SSRS

Kristaq Bollano, Instituti i Statistikave  
kbollano@instat.gov.al

Liljana Boçi, Instituti i Statistikave  
lboçi@instat.gov.al

## Abstrakt

Synimi i këtij studimi është analizimi i saktësisë së zgjedhjes për një seri kohore 12-mujore të anketës së Besimit të Biznesit për vitin 2018. Qëllimi është të ndërtohet një funksion i gatshëm në R i cili të mundësojë llogaritjen e variancës për grupet homogjene të përgjigjura në SSRS pa zëvendësim. Për të provuar saktësinë e rezultateve do të përdorim simulimet Monte-Carlo.

Anketa e Besimit të Biznesit siguron të dhëna, fakte dhe informacione për kushtet e bizneseve bazuar ne opinionin e tyre, duke pasur parasysh zhvillimet ekonomike në vend.

## Fjalët kyçe:

Varianca; R; Simulime Monte-Carlo; Anketa e Besimit të Biznesit; SSRS

## 1. HYRJE

Në këtë artikull do të paraqesim një kodim të ri në R që do të shërbejë për llogaritjen e variancës për totalin e vlerësuar në metodën SSRS (Stratified Simple Random Sampling). Në fillim do të paraqitet një material teorik për sa i përket variancës në SSRS në grupet homogjene të përgjigjura.

Që nga viti 2005, Instituti i Statistikave përdor një manual, CLAN-MACRO në Software-in SAS për llogaritjen e kësaj variance. Manuali CLAN, i përgatitur nga ekspertë suedezë përmban udhëzime se si të kryhen vlerësime dhe llogaritje për një sërë metodash, përfshirë variancën e vlerësuar të totalit të vlerësuar. Kalimi nga SAS në R anashkalon probleme të tilla si kosto e licensimit, mirëmbajtjes dhe fleksibilitetit të përdorimit të software-it SAS.

Metoda të ndryshme të avancuara për llogaritjen e variancës si: *Vlerësimin Horvitz-Thompson (H-T)*, *Vlerësimin e Përgjithësuar (GREG)* dhe *“Vlerësimin Bootstrap”* janë në përdorim të vazhdueshëm nga software të ndryshëm. Ndërkohë e gjithë kjo procedurë do të aplikohet mbi Anketën e Besimit të Biznesit 2018 në një interval 12-mujor mbi indikatorin *total* të të punësuarve.

Në fakt, për këtë procedurë ekzistojnë disa komanda të gatshme në R, konkretisht në paketën *Survey*, të cilat janë: *svydesign* (e cila shërben për krijimin e dizajnit mbi variablat e përfshirë në llogaritje) dhe *svytotal* (e cila shërben për llogaritjen e variancës mbi dizajnin e ndërtuar).

Me anë të Teoremës Qendrore Limite dhe simulimeve Monte-Carlo do të shihet afrimiteti i 10 mijë kampioneve të simuluar të Anketës së Besimit të Biznesit.

Njëkohësisht një tjetër pikësynim është që i gjithë funksioni i programuar në R të jetë i thjeshtë në përdorim edhe për një përdorues modest R-je.

## 2. MATERIALI TEORIK

### 2.1. Problemi i vlerësimit

Le të konsiderojmë bashkësinë e ndryshoreve  $Y_1, \dots, Y_p, \dots, Y_P$  ku  $1, 2, \dots, p, \dots, P \in P$  dhe  $Y_{pK}$  është vlera e ndryshores  $Y_p$  për elementin  $k$  në një popullatë të fundme  $U$ . Gjithashtu konsiderojmë që prerja e bashkësive  $U$  dhe  $D$  japin  $U_1, U_2, \dots, U_D$  ku  $U_1, U_2, \dots, U_D \in D$ . Atëherë mund të përcaktojmë që për secilin nga kombinimet e mundshme të  $y_p \in D$  dhe bashkësive  $U_D \in D$ , do i përkasin bashkësisë karteziane  $P \times D$  dhe totali është:

$$t_{pd} = \sum_{k \in U_D} y_{pk} = \sum_{k \in U} y_{pk} c_{dk} \text{ ku } c_{dk} = \begin{cases} 1 & \text{ngs-} k \in U_D \\ 0 & \text{ndryshe} \end{cases} \quad (2.1.1)$$

Në përgjithësi, vetëm totalët e një prej kombinimeve brenda  $P \times D$  është në interes për t'u studiuar. Le të jetë vektori  $t = (t_1, t_2, \dots, t_j, \dots, t_J)$ , vektori i  $J$  totaleve që janë brenda interesit. Nga ana tjetër çdo  $t_j$  për  $1, 2, \dots, j, \dots, J \in J$  brenda vektorit  $t$  shoqërohet me ndryshoren  $y_p$  në bashkësinë  $U_D$ . Formalisht kemi  $t_j = \sum_{k \in U_D} y_{p(j)k}$  ku për arsye mosngarkimi të simbolikës, me marrëveshje do të kemi  $y_{p(j)} = y_p$  dhe  $U_{d(j)} = U_j$ . Vektori  $t$  i totaleve gjenerohet nga  $J$  kombinimet të ndryshoreve  $y$ . Nga njëra anë  $t$  mund të jetë vektor i totaleve të një ndryshori  $y$  ( $P=1$ ) në ( $J=D$ ) fushat e ndryshme  $U_1, U_2, \dots, U_J$ . Nga ana tjetër  $t$  mund të jetë vektori i totaleve të një bashkësie ( $D=1$ ) për ( $J=P$ ) ndryshore të ndryshme.

Le të jetë  $f$  me marrëveshje, funksioni që bën të mundur llogaritjen e totalit për të gjitha totalët në vektorin  $t$ . Nëse do të shënonim me  $\theta$  rezultatin nga funksioni  $f$  atëherë do të kishim:

$$\theta = f(t_1, t_2, \dots, t_j, \dots, t_J)$$

Funksioni i ndërtuar në  $R, \hat{\theta}$  do të jetë vlerësues i  $\theta$ , pra:

$$\hat{\theta} = f(\hat{\mathbf{t}}) \quad (2.1.2)$$

ku  $\hat{\mathbf{t}} = (\hat{t}_1, \dots, \hat{t}_j, \dots, \hat{t}_J)'$  është një vlerësim linear i  $\theta$ .

Kur kemi të bëjmë me një vrojtim të shtresëzuar me zgjedhje të rastësishme të thjeshta për grupet homogjene të përgjigjura llogaritja e totalit si një vlerësim do të jetë i një natyre të ndryshme nga ajo me grupe të papërgjigjura.

Në rastin me grupe të papërgjigjura nënkupton që grupet kanë përgjigje që janë të pavarura dhe me një probabilitet të njëjtë përgjigjeje brenda stratës.



Ndërsa në rastin e grupeve të përgjigjura, ndryshimi qëndron sepse strata  $h$  është e ndarë në  $L_h$  grupe homogjene të përgjigjura, ku brenda këtyre grupeve përgjigjet janë të pavarura dhe me një probabilitet të njëjtë përgjigjeje.

Supozojmë se  $r_{gh}$  është bashkësia e njësive të zgjedhura të përgjigjura brenda grupit  $g$  dhe stratës  $h$ . Supozojmë gjithashtu se popullata është e panjohur për çdo grup.

Në stratën  $h$  dimë,

$N_h$  numrin e popullatës brenda stratës  $h$

$n_h$  numrin e njësive të zgjedhura brenda stratës  $h$

Në grupet homogjene të përgjigjura  $hg$ ,  $g=1,2,\dots,L_h$  dhe në përgjithësi në grupin  $g$  dhe stratën  $h$  dimë,

$n_{hg}$  numrin e njësive të zgjedhura brenda grupit  $g$  dhe stratës  $h$ , ose ndryshe grupit  $hg$

$m_{hg}$  numrin e njësive të zgjedhjeve të përgjigjura brenda  $r_{hg}$

Totali  $t_y$  i ndryshores  $y$  llogaritet sipas një vlerësimi me formulën,

$$\hat{t} = \sum_{h=1}^H \frac{N_h}{n_h} \sum_{g=1}^{L_h} \frac{n_{hg}}{m_{hg}} \sum_{r_{hg}} y_k \quad (2.1.3)$$

Njëkohësisht (2.1.3) shprehet:

$$\hat{t} = \sum_{h=1}^H \sum_{g=1}^{L_h} \frac{\hat{N}_{hg}}{m_{hg}} \sum_{r_{hg}} y_k \quad (2.1.4)$$

Në bazë të kësaj formule që llogarit totalin, tashmë llogaritet varianca e këtij totali që shërben si një vlerësim, (shiko Särndal et al (1992) p 582),

$$\hat{V}(\hat{t}) = \sum_{h=1}^H N_h(N_h-1) \sum_{g=1}^{L_h} \frac{n_{hg}}{n_h} \left( \frac{n_{hg}-1}{n_h-1} - \frac{m_{gh}-1}{N_h-1} \right) \frac{1}{m_{hg}} s_{y_{hg}}^2 + \sum_{h=1}^H N_h \frac{N_h-n_h}{n_h-1} \sum_{g=1}^{L_h} \frac{n_{hg}}{n_h} \left( \frac{N_h-n_h}{n_h-1} \right)^2 \quad (2.1.5)$$

ku,

$$\overline{y_{hg}} = \frac{1}{m_{hg}} \sum_{r_{hg}} y_k \quad \overline{y_{hg}} = \sum_{g=1}^{L_h} \frac{n_{hg}}{n_h} \overline{y_{hg}}, \text{ dhe } s_{y_{hg}}^2 = \frac{1}{m_{hg}-1} \left[ \sum_{r_{hg}} y_k^2 - m_{hg} \overline{y_{hg}}^2 \right]$$

Formula (2.1.5) ka kuptim nëse  $m_{hg} \neq 0$ ,  $m_{hg} \neq 1$ ,  $n_h \neq 0$ ,  $n_h \neq 1$ ,  $N_h \neq 1$

Pikërisht formula (2.1.5) është formula që ndërtohet në trajtën e një funksioni në R i cili bën të mundur gjenerimin e Variancës së Totalit në rastin e Grupeve Homogjene të Përgjigjura me metodën e Zgjedhjes së Thjeshtë të Rastësishme të Shtresëzuar.

## 2.2 Simulimet Monte-Carlo

Simulimi Monte-Carlo është një teknikë e kompjuterizuar që mbështet në marrjen e kampionimeve të ndryshme, me qëllim për të përfituar rezultate objektive. Në këtë artikull do të merren 600 kampionë dhe nga rezultatet e formulës (2.1.5) dhe komandave të gatshme në R do të analizohet afrimiteti me variancën ideale. Llogaritja e variancës ideale do të bëhet mbi variablin të punësuar.

$$\text{Formula e variancës ideale është: } V = \sqrt{\frac{1}{N-1} \sum_{i=1}^{600} (\hat{t}_i - \bar{t})^2} \quad (2.2.1)$$

Meqënëse varianca ideale kërkon 100,0 % të bizneseve të përgjigjura, atëherë të dhënat e marra nga Regjistri i Biznesit do të supozohen si biznese të tilla. Gjithsej 600 simulime të gjeneruara dhe me anë të teoremës qendrore limite mjafton për të krahasuar dy mënyrat e llogaritjes.

## 3. ANKETA E BESIMIT TË BIZNESIT

Anketa e Besimit të Biznesit ka një proces kampionimi një herë në vit dhe një proces peshimi një herë në muaj. Ky anketim kryhet nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave që nga viti 2002. Rezultatet e vrojtimeve të besimit janë përdorur për të plotësuar informacionin e marrë nga statistikave zyrtare në analizat periodike të Bankës së Shqipërisë. Ato janë përdorur për më shumë se tetë vjet si një lëndë për modele parashikimi ekonomike afatshkurtar.

### 3.1. Popullata dhe baza e zgjedhjes

Sektorët që marrin pjesë në përbërjen e popullatës, për Anketën e Besimit të Biznesit janë *industria, ndërtimi, shërbimet dhe tregëtia me pakicë*. Të gjitha këto të dhëna merren nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve pranë Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT). Ky regjistër përfshin të gjitha njësitë ligjore të regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe pranë Organeve Tatimore. Nga ana tjetër, për popullatën që do përdoret në kampionim do të bëhet paraprakisht një proces përjashtimi. Ky proces bëhet për të zvogëluar bazën e zgjedhjes dhe rrjedhimisht të kemi një kampion me eficient. Përjashtimi bëhet për bizneset me më pak se 2 të punësuar në sektorin e *ndërtimit dhe tregtisë me pakicë* dhe më me pak se 5 të punësuar në sektorin e *industrisë dhe shërbimeve*.

Tabela 1: Kampioni dhe baza e zgjedhjes para dhe pas përjashtimit

Sektori	Popullata në numër biznesesh të regjistruara në RSN	Baza e zgjedhjes para përjashtimit	Baza e zgjedhjes pas përjashtimit	Kampioni
Industri	8.724	8.724	2.410	412
Ndërtim	4.601	4.601	2.676	218
Shërbime	50.066	50.066	5.660	352
Tregti me pakicë	39.360	39.360	13.632	412

Burimi: Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve 2018

Për *industrinë*, baza e zgjedhjes pas përjashtimit përbën 27,0 % të numrit të ndërmarrjeve dhe përfaqëson 93,0 % të xhiros totale të sektorit dhe ka të punësuar 80,0 % të totalit të punonjësve.

Për *ndërtimin*, në bazën e zgjedhjes pas përjashtimit janë përfshirë 59,0 % e ndërmarrjeve, të cilat përfaqësojnë 99,0 % të xhiros dhe 94,0 % të të punësuarve të sektorit të ndërtimit.

Baza e zgjedhjes së vrojtimit të *shërbimeve* përfshin vetëm 11,0 % të totalit të ndërmarrjeve në këtë sektor, duke treguar për shkallën e lartë të fragmentimit. Këto ndërmarrje, nga ana tjetër, përfaqësojnë 80,0 % të xhiros dhe 48,0 % të të punësuarve në sektorin e shërbimeve.

Së fundmi, në sektorin e *tregtisë me pakicë*, numri i bizneseve në bazën e zgjedhjes përbën 34,0 % të të gjithë popullatës nga RSN (gjithë sektori i tregtisë). Këto biznese zënë një peshë 85,0 % sipas vlerës së shtuar dhe 64,0 % sipas numrit të të punësuarve.

### 3.2. Kampionimi

Në rastin e Anketës së Besimit të Biznesit kampioni zgjidhet nëpërmjet zgjedhjes rastësore, pasi në këtë mënyrë sigurohemi se do të prodhohet të dhëna më të besueshme pa qenë nevoja të bëhen supozime. Ndërkohë për të rritur efektivitetin e kampionit është e nevojshme që popullata të ndahet në grupe apo shtresa me karakteristika të veçanta.

Në këtë anketë shtresëzimi i popullatës bëhet me anë të dy kritereve:

- 1) Aktiviteti ekonomik
- 2) Madhësia e ndërmarrjes

Teorikisht madhësia përcaktohet me anë të formulës,  $\frac{\sqrt{V(t)}}{t} \leq \alpha$

ku  $\alpha$  - precizioni i kërkuar,  $t$ - totali i punësimit,  $V(t)$  - varianca e totalit.


## 4. REZULTATE

E gjithë ana teorike e shtjelluar deri më tani praktikohet mbi Anketën e Besimit të Biznesit me anë të software-it R.

Formula (2.1.5) do të kodohet në R. Kodimin e formulës të shprehur në trajtë funksioni do ta gjeni në Shtojcë.

Më poshtë paraqitet seria kohore 12-mujore e variancës sipas funksionit të ndërtuar.


Grafiku 1: Paraqitja grafike e variancës 12-mujore sipas funksionit të ndërtuar me formulën (2.1.5)



Burimi: Varianca në seri 12-mujore

Ndërkohë që nga rezultatet e Simulimeve Monte-Carlo do të kemi:

Grafiku 2: Paraqitja grafike e Simulimeve për funksionin e ndërtuar rihstaz dhe komandat në R



Burimi: Varianca në seri 12-mujore

Me ngjyrë lejla është seria kohore e funksionit të ndërtuar sipas formulës (2.1.5) dhe me ngjyrë të kuqe seria kohore e output-it të komandës së gatshme në R.

Me anë të grafikut 2 vëmë re se në një spektër të gjerë mbulimi, funksioni i ndërtuar sipas formulës (2.1.5) ka vlera variance më të larta sesa komandat e gatshme në R.

Varianca ideale e gjeneruar nga formula (2.2.1) është 6131.

Nga ana tjetër, mesatarja e variancës për 600 kampione, respektivisht nga formula (2.1.5) dhe komandat në R janë 6159.99 dhe 6201.44.

Në qoftë se do të bënim një krahasim midis variancës ideale dhe variancave të gjeneruara nga funksioni i ndërtuar dhe komanda e gatshme në R atëherë:

$$6131 < 6159.99 < 6201.44$$

## 5. KONKLUZIONE

Me anë të Teoremës Qendrore Limite gjejmë variancën e funksionit, variancën që gjenerohet nga komandat e gatshme në R dhe variancën ideale. Simbolikisht:  $V_1$ ,  $V_2$  dhe  $V_{ideale}$ .

$V_1$  është afër  $V_{ideale}$  sesa  $V_2$ , rrjedhimisht dalim në përfundimin që:

1. *Funksioni jep një variancë ( $V_1$ ), që merr në konsiderat formulën e saktë për grupet homogjene të papërgjigjura.*
2. *Nga krahasimi midis  $V_1$ ,  $V_2$  dhe  $V_{ideale}$  dalim në përfundimin që ky funksion është mjaft i dobishëm*

### BIBLIOGRAFIA

- [1] Särndal, C., Swensson, B. and Wretman, J. (1992), *“Model Assisted Survey Sampling”*.
- [2] Robert, Ch., and Casella, G., (1999) *“Monte Carlo Statistical Methods”*.
- [3] Andersson, C. and Nordberg, L., (1997), *“CLAN – a SAS-Program for Computation of Point - and Standard Error Estimates in Sample Surveys”*, Örebro, Sweden. Retrieved from [https://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/Annexes/ef\\_esqrs\\_fi\\_an5.pdf](https://ec.europa.eu/eurostat/cache/metadata/Annexes/ef_esqrs_fi_an5.pdf).
- [4] Kristo, E., (2017), *“Metodologjia e Vrojtimeve të Harmonizuara të Besimit”*, Publikim nga Banka e Shqipërisë. Tiranë, Shqipëri. Marrë nga [https://www.bankofalbania.org/rc/doc/metodologjia\\_e\\_vrojtimeve\\_te\\_harmonizuara\\_te\\_besimit\\_9783.pdf](https://www.bankofalbania.org/rc/doc/metodologjia_e_vrojtimeve_te_harmonizuara_te_besimit_9783.pdf).
- [5] Snijkers, G., Haraldsen, G., Jones, J. and Willimack, D., (2013), *“Designing and Conducting Business Surveys”*.
- [6] Wickham, H. and Grolemond, G., (2016), *“R for Data Science: Import, Tidy, Transform, Visualize, and Model Data”*, 1st edition.
- [7] Lumley, Th., (2011), *“Complex Surveys: A Guide to Analysis Using R”*.

## SHTOJCË 1:

```
function(A){
```

```
  A$prata=as.character(A$prata)
```

```
  A=A[order(A$prata),]
```

```
  table(A$prata)
```

```
  S=1
```

```
  V1=0
```

```
  h=1
```

```
  E=table(A$prata)[[h]]
```

```
  for (h in 2:length(table(A$prata))) {
```

```
    SH_e_Yk=sum(A$employed[S:E])
```

```
    Y_hg=(1/A$mhg[S])*SH_e_Yk
```

```
    Y__h=sum((A$nhg[S]/A$n_smallOut[S])*Y_hg)
```

```
    SH_e_Y2k=sum((A$employed[S:E])^2)
```

```
    s2_yhg=(1/(A$mhg[S]-1))*(SH_e_Y2k-(A$mhg[S]*(Y_hg)^2))
```

```
    M4=(A$nhg[S]/A$n_smallOut[S])*((Y_hg - Y__h)^2)
```

```
    M3=A$NOut[S]*((A$NOut[S]-A$n_smallOut[S])/(A$n_smallOut[S] - 1))
```

```
    M2=(A$nhg[S]/A$n_smallOut[S])*(((A$nhg[S]-1)/(A$n_smallOut[S]-1))-((A$mhg[S]-1)/(A$NOut[S]-1)))*(1/A$mhg[S])*s2_yhg
```

```
    M1=A$NOut[S]*(A$NOut[S]-1)
```

```
    M=(M1*M2)+(M3*M4)
```

```
    S=1+E
```

```
    E=table(A$prata)[[h]]
```

```
    E=E+S-1
```

```
  V1=V1+M
```

```
}
```

```
SH_e_Yk=sum(A$employed[S:E])
```

```
Y_hg=(1/A$mhg[S])*SH_e_Yk
```

```
Y__h=sum((A$nhg[S]/A$n_smallOut[S])*Y_hg)
```

```
SH_e_Y2k=sum((A$employed[S:E])^2)
```

```
s2_yhg=(1/(A$mhg[S]-1))*(SH_e_Y2k-(A$mhg[S]*(Y_hg)^2))
```

```
M4=(A$nhg[S]/A$n_smallOut[S])*((Y_hg - Y__h)^2)
```

```
M3=A$NOut[S]*((A$NOut[S]-A$n_smallOut[S])/(A$n_smallOut[S] - 1))
```

```
M2=(A$nhg[S]/A$n_smallOut[S])*(((A$nhg[S]-1)/(A$n_smallOut[S]-1))-((A$mhg[S]-1)/(A$NOut[S]-1)))*(1/A$mhg[S])*s2_yhg
```

```
M1=A$NOut[S]*(A$NOut[S]-1)
```

```
M=(M1*M2)+(M3*M4)
```

```
V1=V1+M
```

```
V1
```

```
semployed1=sqrt(V1)
```

```
return(semployed1)
```

```
}
```



# QËNDRUESHMËRIA E BORXHIT PUBLIK RASTI I SHQIPËRISË

Elma Çali, Instituti i Statistikave  
ecali@instat.gov.al

Sokrat Palushi, Instituti i Statistikave  
spalushi@instat.gov.al

## Abstrakt

Koncepti i qëndrueshmërisë së borxhit publik, i ndikuar edhe nga kriza financiare e vitit 2008, ka qenë fokusi kryesor i shumë studiuesve, duke pasur parasysh pasojat e rënda që mund të gjenerojë keqpërdorimi i huave publike. Ky artikull, përpos trajtimit teorik të qëndrueshmërisë së borxhit publik, ka si qëllim analizimin e rezultateve, të gjeneruara nga metodat empirike, sa të borxhit publik në Shqipëri për një periudhë 10-vjeçare. Borxhi publik do të shqyrtohet përmes ndikimit të tij në treguesit më të rëndësishëm makroekonomikë, duke evidentuar dhe impaktin e tij në rritjen ekonomike të vendit tonë. Rezultatet e gjeneruara përforcojnë faktin se politika më e sigurt për ta përballuar borxhin është nëpërmjet stimulimit të rritjes ekonomike dhe mbajtjes së nivelit të borxhit brenda parametrave të lejuar.

## Fjalë kyçe:

Borxh publik; Rritje ekonomike; Stabilitet makroekonomik; Zhvillim i qëndrueshëm

## **1. HYRJE**

Politikat e paqëndrueshme fiskale mund të përkeqësojnë kushtet makroekonomike dhe t'i bëjnë ekonomitë më të prekshme ndaj goditjeve ekzogjene. Një politikë e paqëndrueshme fiskale mund të dëmtojë mirëqenien e vendit përmes deficiteve të mëdha dhe stoqeve të tepërta të borxhit publik, duke gjeneruar një alokim joefiçent të burimeve dhe rezervave të tepërta të borxhit, që mund të ndikojnë edhe brezat e ardhshëm.

Për më tepër, një politikë e paqëndrueshme fiskale mund të sjellë një rritje në normën e inflacionit dhe paqëndrueshmërinë e tij. Këto pasoja të dëmshme nuk janë vetëm hipotetike. Ato janë konfirmuar nga fakti se shumë ekonomi të zhvilluara kanë arritur në një pikë kritike me politikat e tyre fiskale (rasti më i rëndësishëm ai i Greqisë). Kjo është arsyeja pse sigurimi i qëndrueshmërisë fiskale është tepër i rëndësishëm.

Greçia është një shembull që, pas goditjes së krizës financiare të vitit 2008, ndoqi një regjim të shtrëngimit ekonomik përmes shkurtimit të shpenzimeve qeveritare. Ky regjim ka një efekt pozitiv për një periudhë afatmesme, derisa garantohet rivendosja e ekuilibrit makroekonomik. Gjithashtu, Greçia pati një ulje të ritmit të rritjes së huave të reja me probleme, e cila është një çështje kyçe për të ardhmen e sektorit të huadhënies.

Megjithatë, vetëm politika e qëndrueshmërisë fiskale nuk mjafton, pasi politika më efikase për zvogëlimin e huamarrjes, pra ulja e deficitit buxhetor, është përmes rritjes së Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Nxitja e rritjes ekonomike krijon stabilitet në vend, duke zgjeruar edhe bazën e të ardhurave të taksueshme.

Nevoja për të arritur standardet minimale të jetesës, krijuar mundësi punësimi, infrastrukturë dhe për të nxitur rritjen ekonomike, mund të tejkalojë shpenzimet krahasuar me të ardhurat e qeverisë. Qeveria mund të jetë në gjendje të shpenzojë më tepër se të ardhurat e saj, të paktën përkohësisht, nëpërmjet mënyrave të mëposhtme; duke emetuar monedhën ose duke emetuar borxhin. Shumica e ekonomistëve e kundërshtojnë metodën e financimit nëpërmjet emetimit të monedhës, pasi kjo do të shkaktonte menjëherë rritje të ofertës së parasë, për pasojë edhe inflacion.

Në pjesën e parë të artikullit pasqyrohet rishikimi i literaturës mbi këtë koncept. Literatura mbi

qëndrueshmërinë e borxhit publik është shumë e gjerë dhe e trajtuar fillimisht nga autorë klasikë si Hume, Smith dhe Ricardo, të cilët e shqyrtuan borxhin publik kryesisht në drejtimin e efekteve të tij të përgjithshme në ekonomi. Më pas, shqyrtohen kushtet për qëndrueshmërinë e financave publike dhe më gjerë trajtohet rasti i Shqipërisë nëpërmjet analizimit të ecurisë së borxhit publik, ku përmes metodave empirike arrihet në një përfundim, i cili përforcon lidhjen e rëndësishme që ka rritja ekonomike e vendit me nivelin e borxhit publik.

## **2. RISHIKIMI I LITERATURËS**

### **2.1 Teori mbi konceptin e qëndrueshmërisë së borxhit publik**

Shumë studiues kanë dhënë pikëpamjet e tyre lidhur me konceptin e borxhit publik dhe qëndrueshmërisë së tij.

Keynes (1923), në trajtimin e tij për këtë çështje pohon se kur një qeveri rrit shpenzimet, si një mjet i politikës fiskale për të ndihmuar stimulimin e një ekonomie në recesion, këto shpenzime duhet të kompensohen nga tepricat gjatë zgjerimit ekonomik në një përpjekje për të shmangur një përshkallëzim të borxhit publik. Domar (1944) pohon gjithashtu se huamarrja e vazhdueshme e qeverisë çon në një rritje të borxhit publik, që shoqërohet edhe nga taksa më të larta. Por, vendosja e vazhdueshme e taksave të reja çon në recesion dhe në mospagim në kohë të borxhit.

Blanchard, Chouraqui, Hagemann dhe Sartor (1990) e mbështetën këtë pikëpamje, duke përmendur faktin se politika fiskale është e qëndrueshme kur borxhi publik nuk rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe qeveria nuk është e detyruar të rrisë taksat ose të ulë shpenzimet, në mënyrë që të shmangë mospagimin e borxhit.

Buiter (1985) deklaroi se borxhi publik është i qëndrueshëm vetëm në qoftë se qeveria mban raportin e vlerës neto të sektorit publik të prodhimit në nivelin e tij aktual. Kjo presupozon se vlera aktuale e tepricave primare të pritshme duhet të jetë e barabartë me nivelin aktual të borxhit publik. Focerrada (2005), në një përpjekje për të interpretuar krizat e viteve 1982 dhe 1994-1995 në Meksikë, pohoi se zhvillimi i tregut të kapitalit dhe parasë, në bashkëpunim me sistemin bankar, mund të kontribuojnë në zhvillimin financiar në përgjithësi. Më pas, fleksibiliteti që ka qeveria për të marrë hua në tregun e brendshëm do të varet më pak



nga tregjet ndërkombëtare, ku normat e interesit mund të jenë më të larta. Financimi i brendshëm kapërcen në një farë mase problemin e qëndrueshmërisë së borxhit publik.

Easterly (1994) mbështeti pikëpamjen se qeveria nuk duhet të lejojë rritjen në shkallë të lartë të borxhit publik, për shkak të rrezikut të mospagimit të tij. Carlin dhe Soskise (2005) argumentuan se borxhi publik mund të jetë i qëndrueshëm kur ai është përdorur për qëllime investimi dhe jo për financimin e nevojave të konsumatorëve.

Papadhopulos dhe Sidiropoulos (1999) pohuan se detyrimet aktuale të qeverisë duhet të kompensohen nga tepricat fiskale në të ardhmen, për ta bërë borxhin të qëndrueshëm. Nëse qeveria vazhdon huamarrjen pa zbatimin e masave të zhvillimit, borxhi publik mund të bëhet i paqëndrueshëm.

Frenkel dhe Razin (1996) mbështetën pikëpamjen se në rastet e shmangies së falimentimit, politikëbërësit duhet të miratojnë programet e konsolidimit fiskal me rritjen e taksave dhe shkurtrimin e shpenzimeve qeveritare. Megjithatë, përfshirja e masave të rrepta fiskale mund të prishë kohezionin social dhe të shkaktojë mostabilitet politik.

Metoda e vlerësimit të qëndrueshmërisë fiskale është një qasje që shqyrton marrëdhëniet afatgjata mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Analizat dalin në përfundimin se shpenzimet qeveritare, duke përfshirë edhe pagesat e interesit, dhe të ardhurat totale nuk duhet të ndryshojnë nga njëri-tjetri në periudhën afatgjate. Në qoftë se ata ndryshojnë, qëndrueshmëria fiskale nuk mund të jetë e realizueshme.

Curtasu (2011) shqyrtoi evolucionin e borxhit publik në Bashkimin Evropian për periudhën 1970-2012. Ajo doli në përfundimin se ka vetëm disa vende si Danimarka, Finlanda, Holanda dhe Suedia të cilat nuk preken nga risku i mosshlyerjes së borxhit. Raporti i tyre i borxhit publik ndaj PBB-së është përgjithësisht më i ulët se 60,0 %, kufi i vendosur nga Traktati i Maastricht, dhe teprica e tyre primare është mjaft e madhe për të stabilizuar borxhin e tyre publik (përveç Holandës). Megjithatë, vende të tjera si Franca, Irlanda, Italia, Portugalia, Spanja dhe Britania e Madhe, të cilat kanë raporte të larta borxhi ndaj PBB-së dhe deficit primar (ose tepricë të ulët), duket se përballen me vështirësi në shërbimin e borxhit të tyre. Së fundmi, Greqia është një vend me nivele të larta të borxhit, me

një konkurrueshmëri të ulët dhe të paafte për të shërbyer borxhin e saj.

## 2.2 Kushtet për qëndrueshmërinë e financave publike

Pikënisja për diskutim për qëndrueshmërinë e borxhit është kufizimi buxhetor i qeverisë, i cili kërkon që shpenzimet aktuale për mallra dhe shërbime plus kostoja e shërbimit të borxhit aktual të jenë të barabartë me të ardhurat tatimore aktuale plus lëshimin e borxhin të ri.

Kjo mund të ilustruhet si më poshtë: Supozojmë se huamarrja e qeverisë merr formën e obligacioneve të një periudhe ku paguhet një normë interesi  $i > 0$  në periudhën  $t$ . Shpenzimet e qeverisë për mallrat dhe shërbimet në periudhën  $t$  janë të përcaktuara nga  $g_t$ ,  $t_t$  që nënkuptojnë të ardhurat nga taksat në periudhën  $t$ , dhe  $b_t$  që tregon borxhin e qeverisë të lëshuar në periudhën  $t$ . Relacioni i kufizimit buxhetor të qeverisë në periudhën  $t$  do të jepet si më poshtë:<sup>1</sup>

$$g_t + (1+i_t)b_{t-1} = t_t + b_t \quad (1.1)$$

$g_t$ ,  $t_t$  dhe  $b_t$  janë respektivisht raporti i shpenzimeve qeveritare për mallra dhe shërbime, raporti i të ardhurave tatimore, dhe ai i lëshimit të borxhit ndaj PBB-së në periudhën  $t$ . Lëshimi i borxhit në periudhën  $t$  është i barabartë me borxhin e përgjithshëm në fund të periudhës  $t$ , meqenëse borxhi i qeverisë është supozuar që do të lëshohet si obligacion i një periudhe.

Më pas, ekuacioni (1.1) mund të rishkruhet si:

$$d_t = \frac{1+i_t}{1+y_t} b_{t-1} = b_t, \quad (1.2)$$

ku  $d_t = g_t - t_t$  është raporti i deficitit buxhetor primar dhe  $y_t$  është norma e rritjes së PBB-së. Ekuacioni (1.2), nënkupton se raporti i borxhit rritet në qoftë se qeveria po menaxhon një deficit dhe në të njëjtën kohë norma nominale e interesit e tejkalon rritjen e PBB-së nominale.

Një interpretim i dytë i qëndrueshmërisë së politikës fiskale merr në konsideratë evolucionin e borxhit në afat të mesëm. Këtu qëndrueshmëria është interpretuar si një reduktim i raportit të borxhit ndaj PBB-së gjatë një periudhe të caktuar kohore drejt një raporti të synuar<sup>2</sup>. Ky interpretim i qëndrueshmërisë së borxhit është

1. Balassone, F., dhe D. Franco (2000), "Assessing fiscal sustainability: A review of methods with a view to EMU", In Fiscal Sustainability, ed. Banca d'Italia, 21–60.

2. Blanchard et al. 1990 dhe Wyplosz 2005.

justifikuar kryesisht nga pikëpamja që, qeveritë me nivele të larta të borxhit janë më pak fleksibël për t'u përgjigjur goditjeve negative. Shpenzimet për borxhin e lartë lënë pak hapësirë për ndërhyrjen e politikës fiskale.

Merret në konsideratë kufizimi buxhetor i qeverisë, si më poshtë:

$$\Delta b_{t+1} = b_{t+1} - b_t = (r-n)b_t + d_t + 1 \quad (1.3)$$

ku  $r$  tregon normën reale të interesit dhe  $n$  normën e rritjes reale të PBB-së. Kështu, në mënyrë që të zvogëlohet raporti i borxhit publik, teprica primare duhet të jetë më e madhe se shpenzimet për borxhin, e cila mund të shprehet si:

$$-d_{t+1} \geq (r-n)b_t \quad (1.4)$$

Ekuacioni (1.4), shpreh faktin se raporti i borxhit do të rritet pafundësisht nëse norma reale e interesit e tejkalon rritjen reale të PBB-së, përveç rasteve kur buxheti primar është në tepricë të mjaftueshme. Në këtë qasje, norma e interesit dhe shkalla e rritjes së PBB-së janë marrë si ekzogjene.

### 3. QËNDRUESHMËRIA E BORXHIT PUBLIK: RASTI I SHQIPËRISË

#### 3.1 Ecuria e treguesve makroekonomikë në dekadën e fundit dhe analiza e nivelit të borxhit publik në Shqipëri

Zhvillimet ekonomike të viteve të fundit konstatohet se, si pasojë e krizës globale financiare, ka pasur rritje reale të PBB-së, por më e ngadalësuar sesa viti 2012. Edhe pse remitancat (të cilat vinin kryesisht nga Italia dhe Greqia) kanë pasur një trend në rënie, ndikimi i drejtpërdrejtë i krizës globale financiare ishte i vogël për shkak të ekspozimit të kufizuar në tregjet financiare ndërkombëtare dhe një politike fiskale ekspansioniste iniciuar para krizës.

Duke pasur parasysh rritjen e konsiderueshme të deficitit fiskal si pasojë e akumulimit të faturave të papaguara, reduktimi i borxhit publik kërkoi një korrektim të konsiderueshëm fiskal. Deficiti i jashtëm i llogarisë korrente pati tendencë graduale rënëse, duke qenë se niveli më i lartë i investimeve çoi në zgjerimin e bazës së eksportit dhe konsolidimi fiskal zvogëloi kërkesën për importe.

Shqipëria pati një rritje ekonomike të konsiderueshme në vitin 2018, e favorizuar shumë nga prodhimi i lartë i energjisë elektrike. Inflacioni mbeti i ulët, pavarësisht kushteve monetare shumë lehtësuese.

Pavarësisht mjedisit të favorshëm dhe perspektivës afatshkurtër pozitive, Shqipëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve si pasojë e rritjes së kufizuar ekonomike të BE-së, veçanërisht në partnerët kryesorë të saj tregtarë.

Në mjedisin e brendshëm, dobësitë janë kryesisht të lidhura me sektorin publik që rrjedhin nga borxhi i lartë publik, rritja e detyrimeve të mundshme dhe dobësitë në institucionet publike. Dobësitë e rritjes së brendshme përfshijnë perspektivat demografike dhe ndikimin e rritjes ekonomike nga kushtet klimaterike (Sektori i Energjisë Elektrike).

**Tabela 1: Disa nga treguesit kryesorë makroekonomik në Shqipëri, 2008-2018**

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
PBB reale (norma e rritjes në %)	7,5	3,3	3,7	2,5	1,4	1,0	1,8	2,2	3,3	3,8	4,0
Deflatori PBB-së (norma e rritjes në %)	4,1	2,4	4,5	2,3	1,0	0,3	1,6	0,6	-0,7	1,5	0,8
Të ardhurat dhe grantet (% e PBB-së)	26,9	26,1	26,2	25,4	24,8	24,2	26,3	26,4	27,6	27,7	27,7
Shpenzimet (% e PBB-së)	32,5	33,2	29,3	28,9	28,2	29,2	31,5	30,5	29,5	29,7	29,3
Borxhi Publik (% e PBB-së)	55,1	59,7	57,7	59,4	62,1	70,4	72,0	72,7	72,4	70,1	68,0
Borxhi i brendshëm (% e PBB-së)	36,6	35,8	32,4	33,1	34,1	37,1	38,6	36,3	36,1	35,3	34,7
Borxhi i jashtëm (% e PBB-së)	18,5	23,9	25,3	26,4	28,0	33,3	33,4	36,4	36,4	34,9	33,3

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT, Banka Botërore

“Pika e dobët” mbetet sektori fiskal, pasi borxhi publik është ende i lartë dhe detyrimet e mundshme janë në rritje për Shqipërinë. Vendi ka ende nevojë për financim, por paraqiten rreziqe, veçanërisht në rast ‘shtrëngimi’ të kushteve të financimit të jashtëm.

Zbutja e këtyre rreziqeve dhe mbështetja e rritjes së lartë dhe të qëndrueshme ekonomike kërkon:


- politika efikase për të përmirësuar klimën e biznesit, përmes qeverisjes më të mirë, infrastrukturës së

përshtatshme dhe përmirësimit të aftësive;

- një përmirësim të mëtejshëm të pozicionit fiskal, duke forcuar bazën e të ardhurave;
- veprime për të kufizuar rreziqet nga detyrimet e mundshme të lidhura me PPP-të dhe për të siguruar një menaxhim më të qëndrueshëm të investimeve publike;
- vazhdimin e mbikëqyrjes së fortë të sektorit financiar për të siguruar që rritja e pritshme e kreditimit bankar të mos dobësojë stabilitetin financiar.

Në grafikun 1 pasqyrohet informacioni mbi konsolidimin fiskal në Shqipëri, në dekadën e fundit.

**Grafiku 1: Përbërja e konsolidimit fiskal, 2008-2018**




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Zgjerimi i deficitit buxhetor, pra i borxhit publik, pasqyroj jo vetëm efektin e stabilizuesit automatik në formën e të ardhurave të reduktuara, por edhe një politikë fiskale kundërciklike nëpërmjet rritjes së pagave dhe shpenzimeve kapitale. Kjo u reflektua edhe në rritjen e pagesave të interesit dhe në deficitin primar, ndonëse qeveria arriti të krijonte suficit primar në vitin 2010. Sipas FMN-së (2003), në vendet me ekonomi në tranzicion dhe në zhvillim, mundësia për të gjeneruar suficit të tepërt zvogëlohet, ndërsa niveli i barrës së borxhit lëviz drejt 50,0 % të PBB-së. Kjo tregon se, kur borxhi publik e tejkalon kufirin prej 50,0 %, sjellja e politikës fiskale është e diskutueshme dhe nuk mund të garantojë aftësi paguese financiare pa shkaktuar rritje të mëtejshme të borxhit.

Në aspektin e politikave, kur vendi është mjaft i ekspozuar ndaj goditjeve të tilla si ndërprerja e papritur e kapitalit, informacioni mbi masat e duhura stabilizuese mund të jetë më pak i nevojshëm. Për rrjedhojë, zbatimi i kësaj qasjeje nuk merr në konsideratë pasiguritë në lidhje me luhatshmërinë e rritjes ekonomike, çmimin e eksporteve primare, normën e interesit dhe luhatshmërinë e kursit të këmbimit. Përcaktimi i një raporti të ulët, ndërkohë që niveli fillestar është shumë i lartë, do të kërkonte zbatimin e një politikë fiskale shtrënguese për një periudhë të gjatë kohore [Jonas (2010)]. Kjo, ndër të tjera, mund të sjellë rënie të investimeve publike dhe ngadalësim të rritjes potenciale ekonomike. Ndërkohë, përcaktimi i një niveli më të lartë do të rriste nivelin e raportit të borxhit ndaj PBB-së dhe pagesat e interesit, e për rrjedhojë, do të shtonte shqetësimet mbi qëndrueshmërinë.

**Grafiku 2: Tendanca e borxhit të PBB-së në %, 2008-2018**



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Pas një rritje të shpejtë të borxhit publik në Shqipëri ndërmjet viteve 2010–2013, trajektorja e borxhit publik filloi të kishte një tendencë rënëse pas vitit 2015. Mbështetur nga një rregullim i konsiderueshëm fiskal në tre vitet e fundit, borxhi i përgjithshëm publik ra nga kulmi i tij në nivelin 72,7 % të PBB-së në vitin 2015, në 68,0 % në vitin 2018.

Borxhi i brendshëm përbën 53,0 % të borxhit publik në Shqipëri, nga i cili 98,0 % është në monedhën vendase. Ecuria e borxhit publik është përmirësuar gradualisht, pas përpjekjes së autoriteteve për të kaluar nga financimi i brendshëm afatshkurtër në financimin e jashtëm afatgjatë. Borxhi publik në Shqipëri pritet të bjerë

gradualisht në periudhën afatmesme, por mbetet ende i lartë, duke paraqitur rreziqe të konsiderueshme. Sipas skenarit bazë (FMN, 2019), raporti i borxhit publik ndaj PBB-së parashikohet të arrijë në 56,8 % deri në vitin 2024. Nevojat për financim bruto pritet të mbeten të larta. Raporti i borxhit ndaj PBB-së është i ndjeshëm ndaj rritjes reale të PBB-së, performancës fiskale dhe kostove të huamarrjes.

### 3.2 Modeli empirik mbi qëndrueshmërinë e borxhit publik në Shqipërisë

#### 3.2.1 Metodologjia e përdorur

Modeli që është ndërtuar për analizën e borxhit publik në Shqipëri konsiston në seri kohore për një periudhë 19-vjeçare, nga 2000-2018, ku studimi fokusohet në impaktin e rritjes së PBB-së në borxhin publik të vendit.

Mbledhja e të dhënave mund të realizohet në dy mënyra: nëpërmjet të dhënave primare, të mbledhura nga studiuesit përmes pyetësorëve, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të dhënave sekondare, të cilat janë statistika të mbledhura nga burime të ndryshme, të cilat konsistojnë në materiale dhe punime të shumë autorëve të huaj dhe vendas, artikuj të botuar në revista dhe buletine të ndryshme, të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

Ky model empirik bazohet në të dhënat sekondare. Të dhënat janë marrë nga INSTAT dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

#### 3.2.2 Kufizimet e modelit

Periudha e shkurtër kohore e marrë në shqyrtim kufizohet nga problematikat e theksuara politiko-ekonomike në Shqipëri, pas viteve 1990. Paqëndrueshmëria e zhvillimit ekonomik (që pati një kulminacion në vitin 1997) do të sillte probleme në model për shkak të diferencave të mëdha, prandaj në analizë është marrë një periudhë me një zhvillim të qëndrueshëm. Vlerësimet empirike kërkojnë seri më të gjata kohore, mbi 30 vite, për të pasur rezultate më afër realitetit. Pavarësisht serisë së shkurtër të të dhënave, gjykohet se lidhja ndërmjet variablave është në mbështetje të teorisë makroekonomike.

Një kufizim tjetër në model lidhet me faktin se variabla të tjerë, si për shembull inflacioni, rezultojnë të jetë variabël i parëndësishëm statistiki, në nivelin 5,0 %, që nënkupton se duhet hequr nga modeli. Në teoritë ekonomike, efekti pozitiv i borxhit publik mbi inflacionin mbron pikëpamjen e

Sargent dhe Wallace (1981) që thotë se një rritje e borxhit publik çon në inflacion vendet me nivel të lartë të borxhit. Gjithashtu, studiues si Taghavi (2000), Kwon et al. (2006), Ahmad et al. (2012), Nastansky et al. (2014), Nguyen (2015), Martin (2015) provuan me metoda empirike që borxhi publik ka një ndikim pozitiv në inflacion.

#### 3.2.3 Rezultatet empirike

Pas testeve diagnostikuese modeli përfundimtar është vlerësuar sipas metodës së katroreve më të vegjël. Përpunimi i të dhënave është bërë në programin E-views.

Figura 1: Modeli ekonometrik

Dependent Variable: LOG(PUBLIC DEBT)

Sample: 2000 2018  
Included observations: 19

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	4.266489	0.048034	88.82308	0.0000
LOG(GDP_GROWTH)	-0.097478	0.033093	-2.945547	0.0090
R-squared	0.337909	Mean dependent var		4.136227
Adjusted R-squared	0.298963	S.D. dependent var		0.097607
S.E. of regression	0.081724	Akaike info criterion		-2.071628
Sum squared resid	0.113541	Schwarz criterion		-1.972214
Log likelihood	21.68047	Hannan-Quinn criter.		-2.054803
F-statistic	8.676247	Durbin-Watson stat		0.263686
Prob(F-statistic)	0.009045			

Burimi: Llogaritjet e autorëve

Figura 1 pasqyron vlerësimin e modelit. Duke ndërtuar hipotezat mbi rëndësinë e modelit konkludojmë se:

**Hipoteza 0:**  $\beta_1 = 0$  (Modeli nuk është i rëndësishëm)

**Hipoteza A:**  $\beta_1 \neq 0$  (Modeli është i rëndësishëm)

Në nivelin 5,0 % rezultojnë që norma e rritjes së PBB-së është një variabël statistiki në rëndësinë.

$Log(Public\ debt) = 4.26 - 0.09\ Log(GDP\ growth)$

Nga rezultatet vërejmë se, një rritje me 1,0 % e normës së PBB-së do të shkaktojë një rënie të borxhit publik me 0,09 %. Ky koeficient është i rëndësishëm statistiki. Transformimi i të dhënave në logaritëm ka hequr tendencën nga seritë kohore.

Lidhja negative mes borxhit publik dhe rritjes ekonomike mbështetet gjithashtu nga teoritë, ku sipas Ramey (1995), niveli i lartë i borxhit mund të krijojë kufizime në aftësinë e një vendi për të ndërmarrë politika kundërciklike duke sjellë rritjen e paqëndrueshmërisë së prodhimit dhe zvogëlimin e rritjes ekonomike.

## 4. KONKLUZIONE

Në përfundim të këtij artikulli dalim në rezultatin se borxhi i lartë është një rrezik për stabilitetin makroekonomik të vendit. Borxhi publik i Shqipërisë është i lidhur ngushtësisht me rritjen ekonomike, ku niveli i lartë i borxhit ndikon negativisht në normën e rritjes së PBB-së dhe për pasojë edhe në mirëqenien e qytetarëve. Nevojat financiare afatshkurtra janë të larta dhe borxhi i lartë mund të jetë një pengesë e rëndësishme në rritjen afatmesme.

Megjithatë, kufizimet e modelit për serinë e shkurtër kohore dhe rezultatet empirike për Shqipërinë, përforcojnë lidhjen ndërmjet variablave të borxhit publik dhe rritjes ekonomike.

Goditjet që lidhen me rritjen, bilancin primar, normat e interesit dhe kursit të këmbimit shtyjnë borxhin dhe nevojat financiare bruto të Shqipërisë mbi standardet përkatëse.

Borxhi i lartë është i lidhur me kërkesat e larta për rifinancim të cilat rrisin paqëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve të papritura në perceptimet e tregut. Kjo tregon për rëndësinë e përpjekjeve të vazhdueshme për reduktimin e borxhit.

Një nivel i lartë i borxhit afatshkurtër mund të shkaktojë një sërë krizash në vendet në zhvillim dhe në vendet në nevojë për likuiditet të përhershëm. Prandaj, kur ekonomia është e dobët, politika më e sigurt për ta përballuar borxhin është nëpërmjet stimulimit të rritjes dhe mbajtjes së nivelit të borxhit brenda parametrave të kërkuar.

## BIBLIOGRAFIA

- [1] Barro, R. J. (1979), "On the determination of the public debt", Journal of Political Economy (87), fq. 940–971.
- [2] Drazen, A., (2000), *Political Economy in Macroeconomics*, Princeton: Princeton University Press.
- [3] Elmendorf, D.W., dhe G. N. Mankiw. (1999), *Government debt*", in Handbook of Macroeconomics, ed. by J.B. Taylor, dhe M. Woodford, Vol. 01 of Handbook of Macroeconomics, fq.1615-1669.
- [4] Englmann, F.C.,(2015), "Can Public Debt Be Sustainable? - A Contribution to the Theory of the Sustainability of Public Debt", IVR Working Paper WP, Shkurt 2015.
- [5] European Economy (2014), "Assessing Public Debt Sustainability in EU Member States: A Guide", Shtator 2014.
- [6] Hemming, R.,(2014), "The Macroeconomics Framework for Managing Public Finances", The International Handbook of Public Financial Management, Korrik 2014, fq. 527-529.
- [7] IMF (2013), "IMF Executive Board Concludes 2013 Article IV Consultation with Albania" <https://www.imf.org/external/np/sec/pr/2014/pr14109.htm>
- [8] IMF (2014), "Albania, 2013 Article IV Consultation and Request for Extended Arrangement", IMF Country Report Nr.14/78, International Monetary Fund Washington, D.C.
- [9] IMF (2019), "Executive Board Concludes 2019 Second Post-Program Monitoring for Albania", Press Release, no.19/263.
- [10] INSTAT (2019), *Ekonomi dhe Financë, Llogaritë Kombëtare (GDP)*.
- [11] Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019), Raporte dhe Statistika Fiskale. <http://financa.gov.al/raporte-dhe-statistika-fiskale/>
- [12] Neck ,R., dhe J.E. Sturm. (2008), "Sustainability of Public Debt". Cambridge, MA: MIT Press.
- [13] Roubini, N.,(2001), "Debt Sustainability: How to Assess Whether a Country is Insolvent", Stern School of Business , New York University , Dhjetor 2001.
- [14] Tantos, S., (2012), "Public Debt Sustainability: The Case of Greece", Journal of Reviews on Global Economics, Vol.01, 2012, fq.27-40.
- [15] Thomsen, P.M., dhe S. Brown. (2008), "Fifth Review Under the Three-Year Arrangement under the Poverty Reduction and Growth Facility, Review Under Extended Arrangement, Financing Assurances Review, and Request for Modification of Performance Criteria". Country Report Nr.08/267, International Monetary Fund Washington, D.C.

# STATISTIKAT E VRASJEVE NË SHQIPËRI

Albana Berbiu, Instituti i Statistikave  
aberbiu@instat.gov.al

Ornela Xhembulla, Prokuroria e Përgjithshme  
ornela.xhembulla@pp.gov.al

Blerina Metanj (Subashi), IDRA  
blerina.metanj@idra.al

## Abstrakt

Ky artikull paraqet një analizë të krimeve kundër jetës të kryera me dashje në Shqipëri në pesë vitet e fundit, duke u fokusuar në ato vepra penale që kanë si objekt vrasjen e një individi.

Studimi i vrasjeve me dashje është i rëndësishëm jo vetëm për impaktin që vrasjet kanë, duke qenë se jo vetëm marrin jetën e një qenieje njerëzore, por gjithashtu krijojnë një klimë frike dhe pasigurie. Ky lloj krimi viktimizon familjen dhe komunitetin.

Artikulli bazohet në të dhëna të siguruara nga Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë. Ai jep një analizë përshkruese të trendit të vrasjeve me dashje, të progresit të procedimeve për vrasjet me dashje dhe zbulueshmërisë së tyre. Gjithashtu, paraqet një profil demografik të të pandehurve dhe viktimave. Së fundmi, konkluzionet dhe rekomandimet adresojnë masa për evidentimin e këtij lloj kriminaliteti.

## Fjalë kyçe:

Vrasje me dashje; Të pandehur; Procedime të regjistruara; Viktima

## 1. HYRJE

Termi vrasje është shumë i përhapur dhe përfshin një kategori të gjerë veprash penale. Ky term nënkupton vrasjen e një qenieje njerëzore nga një qenie tjetër njerëzore, me dashje apo nga pakujdesia. Vrasja cenon një nga parimet themelore të të drejtave të njeriut; të drejtën për të jetuar, e mbrojtur kjo posaçërisht nga legjislacioni penal kombëtar dhe e sanksionuar në shumë instrumente ndërkombëtare si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti mbi të drejtat civile dhe politike, etj.<sup>1</sup>

Objekti i vrasjes është mbrojtja juridike që sistemi penal i garanton jetës, ndërkohë që e mira e mbrojtur është pikërisht jeta e çdo njeriu, si e drejtë themelore, e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme. Nga ana objektive, vrasja kryhet me veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme dhe të kundërligjshme të kryera në forma e rrethana të ndryshme. Subjekti aktiv i vrasjes mund të jetë çdo person që në kohën e kryerjes së veprës penale ka mbushur moshën për përgjegjësi penale (14 vjeç) dhe është i përgjegjshëm. Subjekti pasiv është qenia njerëzore. Në disa raste, për kualifikimin e duhur të veprës penale, është e nevojshme që subjekti të jetë mbajtës i disa cilësive ose një statusi të posaçëm. Nga ana subjektive, vrasja kryhet me dashje të drejtpërdrejtë ose indirekte.

Artikulli përfshin në studim vetëm *vrasjet me dashje*, në grupin e krimeve kundër jetës të kryera me dashje, parashikuar në nenet 76-83 të Seksionit I, Kreut të II të Kodit Penal.

Për thjeshtësi, në vijim të artikullit termi “vrasje” përdoret në vend të “vrasje me dashje”.

1. United Nations, Office of the High Commissioner for Human Rights (1982). General Comment No. 06: The right to life (article 6). Para. 1; Universal Declaration of Human Rights, article 3; International Covenant on Civil and Political Rights, article 6.1; Convention on the Rights of the Child, article 6; Geneva Conventions, Common article 3.1.a.

Tabela 1: Nenet e Kodit Penal, pjesë e kategorisë vrasje me dashje

Neni	Përshkrimi
Neni 76	Vrasja me dashje
Neni 77	Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër
Neni 78	Vrasja me paramendim
Neni 78/a	Vrasja për gjakmarrje
Neni 79	Vrasja në rrethana të tjera cilësuese
Neni 79/a	Vrasja e funksionarëve publikë
Neni 79/b	Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit
Neni 79/c	Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare
Neni 81	Vrasja e foshnjës
Neni 82	Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike
Neni 83	Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme

Burimi: Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Në Shqipëri, norma e vrasjeve të regjistruara nga policia në vitin 2018 është 1.8 vrasje për 100 mijë banorë. Ndër vite, kjo normë ka ardhur në rënie, nga 4.4 vrasje të regjistruara në vitin 2011, në 1.8 vrasje në vitin 2018.

Vrasja e grave dhe vajzave mbetet një problem serioz në botë, si në vendet e pasura, ashtu edhe në ato të varfra. Ndërkohë që shumica e viktimave nga vrasjet janë burra, të vrarë nga persona të panjohur, gratë kanë më shumë mundësi të mbeten viktimë nga persona të njohur.

Në vitin 2017, gratë e vrara për shkak të marrëdhënieve familjare përbëjnë 58,0 % të të gjithë grave në botë viktimë e vrasjeve. Norma globale e grave të vrara në vitin 2017 është 2.3 për 100 mijë banorë, ndërkohë norma e grave viktimë për shkak të marrëdhënieve familjare është 1.3 për 100 mijë banorë.<sup>2</sup>

## 2. METODOLOGJIA

Të dhënat për përgatitjen e këtij artikulli janë siguruar nga Prokuroria e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme mbledh të dhëna nga 22 prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë dhe nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda. Procesi i mbledhjes së të dhënave është i njëjtë për të gjithë prokuroritë dhe i normuar me akte nënligjore.

Regjistrat manualë përfshijnë informacion për veprat penale sipas neneve të Kodit Penal, subjektet referuese/kallëzuese, masat e sigurimit, treguesit e ndjekjes penale nisur nga regjistrimi i procedimit, mënyra e përfundimit, ecuria e gjykimit, të dhënat e të pandehurve (emri, mosha, gjinia, recidivizmi, adresa, gjendja civile, shtetësia), detajet e viktimës/ viktimave. Në këto regjistra pasqyrohen të gjitha veprat penale për të cilat

2. [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18\\_Gender-related\\_killing\\_of\\_women\\_and\\_girls.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18_Gender-related_killing_of_women_and_girls.pdf)



regjistrohet procedimi penal, por për qëllime statistikore çështja evidentohet për veprën penale më të rëndë, që bazohet në masën më të lartë të dënimit.

Të dhënat në artikull përfshijnë procedimet e regjistruara sipas neneve specifike të vrasjeve me dashje, të dhëna socio-demografike për të pandehurit për vrasje, si edhe të dhëna për viktimat nga vrasjet.


### 3. REZULTATE

#### 3.1 Procedime penale

Në vitin 2018 janë regjistruar 128 procedime penale për vrasje, 38,8 % më pak procedime penale, krahasuar me vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe, numri i procedimeve të regjistruara për vrasje ka ardhur në rënie, me përjashtim të vitit 2016 dhe 2018 ku procedimet janë rritur krahasuar me vitet respektive paraardhëse. Në vitin 2016, procedimet janë rritur me 22,0 %, krahasuar me vitin 2015 dhe në vitin 2018 procedimet janë rritur me 4,9 %, krahasuar me vitin 2017.

Në kategorinë e vrasjeve, vrasje me dashje, vrasje me paramendim, vrasje në rrethana cilësuese dhe vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare zënë peshën më të madhe në totalin e procedimeve të regjistruara. Gjatë periudhës 5-vjeçare, këto vepra nuk ndjekin një trend të caktuar.

**Grafiku 1: Ecuria e vrasjeve sipas neneve specifike krahasuar me vitin 2014<sup>3</sup>**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Një procedim penal, gjatë ecures së çështjes, mund të pushohet, pezullohet ose dërgohet për gjykim në gjykatë. Në këtë seksion do të paraqesim progresin e procedimeve të vrasjeve gjatë periudhës 2014-2018.

Procedimi penal mund të pushohet kur prokurori, në përfundim të hetimeve paraprake, vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur rastet janë të parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës

3. Ky tregues është llogaritur duke mbajtur vrasjet specifike të vitit 2014 si vit reference, dhe vitet e tjera janë llogaritur si indekse bazuar në këtë vit.

Penale. Pezullimi i procedimit është në vendimmarrjen e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Nga analiza e bërë është vënë re se 99,0 % e rasteve të pezulluara rrjedhin nga fakti që autori nuk njihet. Procedimi dërgohet për gjykim në gjykatë kur prokurori, në përfundim të hetimeve paraprake, ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës.


Vrasje me paramendim, me dashje, vrasje në rrethana cilësuese dhe për shkak të marrëdhënieve familjare përbëjnë përqindjen më të lartë të procedimeve penale të përfunduara.

**Tabela 2: Progresi i procedimeve penale për vrasje**

Viti	Të përfunduar	Të pushuara	Të pezulluara	Për gjykim
2014	188	11,2%	34,0%	54,8%
2015	212	15,1%	43,9%	41,0%
2016	161	18,0%	37,9%	44,1%
2017	115	13,9%	30,4%	55,7%
2018	105	19,0%	41,0%	40,0%


Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

**Grafiku 2: Procedime penale të pushuara sipas llojit të vrasjeve, 2018**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme


**Grafiku 3: Procedime të pezulluara, autori nuk dihet sipas llojit të vrasjeve, 2018**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Ecuria e një procedimi përfundon me dërgimin e çështjes për gjykim në gjykatë. Gjatë periudhës 5-vjeçare, 41,0 % - 56,0 % e çështjeve të përfunduara kanë shkuar për gjykim. Në vitin 2018, përqindja e procedimeve dërguar për gjykim ka rënë krahasuar me vitin 2014; nga 54,8 % në 40,0 % e procedimeve të përfunduara kanë shkuar për gjykim, kjo pasi edhe numri i procedimeve të përfunduara ka rënë gjatë kësaj periudhe.

**Grafiku 4: Procedime penale të përfunduara dhe dërguar për gjykim për vrasje**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare me paramendim në rrethana cilësuese përbëjnë përqindjen më të lartë të procedimeve dërguar për gjykim.


### 3.2 Profili i të pandehurve

Termi i pandehur i referohet personit të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur. Në totalin e të pandehurve janë përfshirë gjithashtu të dhëna për personat nën hetim.

Në vitin 2018 janë regjistruar 116 të pandehur për vrasje, 42,6 % më pak sesa në vitin 2014. Vit pas viti, numri i të pandehurve ka ardhur në rënie, me përjashtim të vitit 2016 dhe 2018 ku numri i të pandehurve është rritur krahasuar me vitin respektiv paraardhës.

Nomra e të pandehurve për 100 mijë banorë ka ndjekur të njëjtin trend si numri absolut i të pandehurve. Në vitin 2018, kjo normë regjistroi 4.0 persona të akuzuar për 100 mijë banorë.

**Grafiku 5: Trendi i normës së procedimeve dhe personave të pandehur për vrasje**




Burimi: Prokuroria e Përgjithshme, INSTAT

Gjatë periudhës 5-vjeçare, të pandehurit për vrasje me dashje, vrasje me paramendim, vrasje në rrethana të tjera cilësuese dhe vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare përbëjnë përqindjen më të lartë të të pandehurve në kategorinë e vrasjeve. Kjo vlen si për të pandehurit e rritur (mbi 18 vjeç), ashtu edhe për të pandehur meshkuj.

### Shpërndarja gjinore

Një fakt i njohur dhe i rëndësishëm për vrasjet është se ato dominohen nga meshkujt, si persona të akuzuar, ashtu edhe si viktimat. Në vitin 2018 janë regjistruar 113 meshkuj të pandehur, 41,1 % më pak, krahasuar me vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe, përqindja e meshkujve të pandehur për vrasje varion nga 95,0 % - 99,0 % të të pandehurve gjithsej, duke folur kështu për të njëjtin trend në llojin e vrasjeve që akuzohen si totali i të pandehurve. Grupi i vrasjeve ku meshkujt rezultojnë me përqindjen më të lartë si të pandehur janë vrasje me paramendim, për shkak të marrëdhënieve familjare, si dhe me dashje. Ky trend vihet re për të gjithë periudhën e studimit.

**Grafiku 6: Përqindja e të pandehurve meshkuj sipas llojit të vrasjeve, 2018**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Gratë përbëjnë më pak se 5,0 % të totalit të të pandehurve për vrasje; numri i tyre ka ardhur në rënie, nga 10 gra të pandehura në vitin 2014 në 3 të pandehura në vitin 2018.

Gjatë viteve 2016-2018, gratë janë të pandehura vetëm për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.

Ndryshe nga të pandehurit meshkuj, ku gjatë kësaj periudhe nuk vihet re një trend në llojin e vrasjeve të kryera, tek gratë vihet re një trend i ngjashëm në llojin e vrasjeve. Kështu, gjatë viteve 2016-2018, gratë janë të pandehura vetëm për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare.

### Shpërndarja moshore

Shumica e të pandehurve janë persona të rritur, mbi 18 vjeç. Gjatë periudhës 2014-2018, përqindja e të pandehurve të rritur varion nga 94,2 % në 99,4 % në totalin e të pandehurve. Numri i të pandehurve të rritur ka ardhur në rënie, duke ndjekur kështu trendin e të pandehurve në total.

Të pandehur të mitur (14-17 vjeç) përbëjnë më pak se 5,8 % të të pandehurve gjithsej. Gjatë periudhës 2014-2018, kjo përqindje varion nga 0,6 % në 5,8 %. Të pandehurit e mitur janë të gjithë djem dhe, ndër vite, nuk shihet një trend në llojin e vrasjeve të kryera.

### Arsimi

Faktorë të tillë si niveli arsimor, punësimi, të ardhurat, vendbanimi konsiderohen si faktorë rrisht në kryerjen e akteve të ndryshme kriminale.<sup>4</sup> Nga të dhënat e siguruar për të pandehurit, vihet re lidhja ndërmjet nivelit të ulët arsimor dhe punësimi i paqëndrueshëm në përfshirjen e personave në vrasje. Të pandehurit me arsim 9-vjeçar përbëjnë përqindjen më të lartë të të pandehurve për vrasje, përqindje e cila varion nga 53,6 % në 67,3 % gjatë kësaj periudhe. Përafërsisht të njëjtat përqindje vihen re dhe për të pandehurit e papunë (58,3 % në 63,2 %), tabelë e pasqyruar në aneks.

### Vendbanimi

Ndryshe nga niveli arsimor dhe punësimi, vendbanimi i të pandehurve nuk përbën ndonjë ndryshim mes të pandehurve me vendbanim urban apo rural. Ndër vite, përqindja e të pandehurve sipas vendbanimit urban dhe rural është përafërsisht e njëjtë. Kështu, në vitin 2018, të pandehurit me vendbanim urban janë 55,4 % dhe të pandehurit me vendbanim rural janë 45,6 %.

4. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3786652/>

### Gjendja gjyqësore

Gjendja gjyqësore nënkupton shënimet në regjistrin e gjendjes gjyqësore lidhur me vendime penale dënimi të një personi. Konsiderohen dy raste kur personi është përsëritës ose i padënuar më parë. Të pandehur përsëritës i referohet personave të dënuar më parë. Ata ndahen në përsëritës të së njëjtës vepër penale ose për vepra të ndryshme nga ajo për të cilën akuzohen. Të padënuar i referohet personave, ndaj të cilëve nuk rezultojnë vendime të mëparshme dënimi.

Ndër vite, pjesa më e madhe e të pandehurve për vrasje janë të padënuar më parë, përqindje e cila varion nga 89,6 % në 96,1 % gjatë viteve 2014-2018. Të pandehur përsëritës për vrasje ka pasur vetëm në vitin 2014, me një rast. Përqindja e përsëritësve për vepra të ndryshme varion nga 3,9 % në 10,4 % gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare.

### 3.3 Profili i viktimave

Viktimë i referohet personit të dëmtuar nga vrasjet. Në totalin e viktimave përfshihen viktimat me pasojë vdekje, plagosje të rëndë dhe plagosje të lehtë.

Në vitin 2018 janë regjistruar 34 viktimat nga vrasjet, 58,5 % më pak krahasuar me vitin 2014. Pas vitit 2015, numri i viktimave nga vrasjet ka rënë. Viktimat nga vrasje me dashje, vrasje me paramendim, vrasje në rrethana të tjera cilësuese dhe vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare përbëjnë përqindjen më të lartë të të gjitha viktimave në kategorinë e vrasjeve.

### Shpërndarja gjinore


Sipas raportit të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) mbi vrasjet me bazë gjinore, një nga ambientet më të rrezikshme për gratë është ambienti familjar. Gjinia dhe mosha e viktimave ka një ndikim të konsiderueshëm mbi probabilitetin për të qenë viktimë e vrasjeve. Shumica e viktimave nga vrasjet janë meshkuj, viktimë nga persona të panjohur<sup>5</sup>.

Meshkujt kanë tre deri në katër herë më shumë të ngjarë të jenë viktimë e vrasjeve sesa gratë dhe përbëjnë 78,9 % - 95,1 % të viktimave gjatë viteve 2014-2018. Viktimat meshkuj nga vrasjet ndjekin të njëjtin trend si totali i viktimave, gjatë kësaj periudhe.

5. Vrasjet me bazë gjinore të grave dhe vajzave, 2018

Gratë viktimë nga vrasjet përbëjnë 4,9 % deri në 21,1 % gjatë kësaj periudhe. Gjatë viteve 2015- 2017, gratë viktimë për shkak të marrëdhënieve familjare përbëjnë përqindjen më të madhe të grave viktimë. Duket se të paktën një nga katër gra viktimë të vrasjeve, është për arsye të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare.

**Grafiku 7: Përqindja e grave viktimë për shkak të marrëdhënieve familjare**



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

### Shpërndarja moshore

Gjatë periudhës 2014-2018, viktimat nga vrasjet mbi 18 vjeç përbëjnë 85,3 % të totalit të viktimave, pjesa tjetër janë të mitur. Nuk vihet re ndonjë lidhje ndër vite ndërmjet viktimave nga lloje të ndryshme të vrasjeve. Gjatë viteve 2014-2016, nuk ka pasur asnjë vajzë (nën 18 vjeç) viktimë nga vrasjet.

## 4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ky artikull paraqet një panoramë të të dhënave për vrasjet. Kuptimi i trendit dhe shtrirjes së vrasjeve është një çështje shumë e rëndësishme pasi prek të gjithë shoqërinë dhe sigurinë e një vendi. Po kështu, të dhënat e vrasjeve mund të ndihmojnë komunitetin ndërkombëtar të kuptojë më mirë kompleksitetin e vrasjeve dhe mënyrat e ndryshme që ndikojnë tek popullata.

Në rangun e procedimeve të pezulluara, mbi 98,9 % e tyre janë pezulluar për shkak të pazbulueshmërisë së autorit. Të dhënat e 5-vjeçarit në studim sugjerojnë se 34,0 % - 41,0 % e çështjeve mbeten të pezulluara për një vit të caktuar. Duke pasur parasysh se 98,9 % e tyre janë për shkak se autori nuk dihet, një faktor kyç në zgjidhjen e një çështjeje është edhe zbulimi i autorit. Për këtë arsye rekomandohen politika që synojnë zbulimin dhe

evidentimin e vrasjeve, të cilat mund të jenë vendosja dhe pajisja me kamera në rrugë për të evidentuar këto raste, ku për vitin 2018, rastet e pezulluara për shkak të vrasjeve me dashje janë 41,0 %.

Të dhënat për të pandehurit sipas gjinisë sugjerojnë se grupi i vrasjeve ku burrat rezultojnë me përqindje më të lartë si të pandehur janë vrasje me paramendim, për shkak të marrëdhënieve familjare, me dashje. Ndërkohë, gratë janë të pandehura vetëm për vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. E njëjta situatë vihet re për personat viktimë nga vrasjet. Duket se të paktën një nga katër gra viktimë të vrasjeve është për arsye të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare. Vërehet se siguria e gruas në shoqërinë shqiptare duhet të shihet jo vetëm jashtë mureve të shtëpisë, por shtëpia mbetet një vend me siguri të ulët për gratë. Ky trend është vënë re edhe në raportin global të UNODC mbi vrasjet me bazë gjinore.

Shpërndarja moshore tregon se mbi 94,2 % e të pandehurve janë persona madhorë. Për të pasur rezultate më specifike për moshën, sugjerohet mbajtja dhe regjistrimi i të dhënave për grupmosha më specifike.

Ky artikull mbetet një nismë për të evidentuar çështjet, personat e pandehur, si edhe personat e dëmtuar për pesë vitet e fundit. Gjithsesi puna mbështetet në situata përshkruese dhe pak mund të bëhet në ndërtimin e modeleve të mirëfillta statistikore. Për këtë qëllim, rekomandohet ngritja e një sistemi elektronik duke vendosur një numër të vetëm identifikues të çështjes. Në këtë mënyrë, ajo mund të gjurmohet dhe analizohet në të gjithë hallkat e sistemit të drejtësisë.

---

## REFERENCA

- [1] Eurostat, Databaza e Krimeve dhe Drejtësisë Penale;  
<https://ec.europa.eu/eurostat/web/crime/data/database>
- [2] Instituti i Statistikave, (2018), Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale; <http://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2018/statistikat-e-krimeve-dhe-drejtësisë-penale-2018/>
- [3] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;  
[http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_penal\\_2017\\_1200.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2017_1200.pdf)
- [4] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;  
[http://www.pp.gov.al/web/kodi\\_i\\_procedures\\_penale\\_date\\_30\\_gusht\\_2017\\_1201.pdf](http://www.pp.gov.al/web/kodi_i_procedures_penale_date_30_gusht_2017_1201.pdf)
- [5] Ministria e Drejtësisë, (2018), Vjetari statistikor;  
<https://drejtesia.gov.al/statistika/>
- [6] Prokuroria e Përgjithshme, (2018), Raporti vjetor; [http://www.pp.gov.al/web/raporti\\_vjetor\\_2017\\_1350.pdf](http://www.pp.gov.al/web/raporti_vjetor_2017_1350.pdf)
- [7] Sociocultural factors that reduce risks of homicide in Dar es Salaam: a case control study; <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3786652/>
- [8] United Nations Office on Drugs and Crime;  
[https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18\\_Gender-related\\_killing\\_of\\_women\\_and\\_girls.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/GSH2018/GSH18_Gender-related_killing_of_women_and_girls.pdf)
- [9] United Nations Office on Drugs and Crime;  
[https://www.unodc.org/documents/gsh/pdfs/2014\\_GLOBAL\\_HOMICIDE\\_BOOK\\_web.pdf](https://www.unodc.org/documents/gsh/pdfs/2014_GLOBAL_HOMICIDE_BOOK_web.pdf)
- [10] The European Institute for Crime Prevention and Control, affiliated with the United Nations (HUENI), Homicide and Gender, 2015;  
[https://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/projects/wd2vDSKcZ/Homicide\\_and\\_Gender.pdf](https://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/projects/wd2vDSKcZ/Homicide_and_Gender.pdf)

### Shtojca I: Terminologjia e përdorur

*Vrasjet në total* në studim përshtjnjë: Vrasja me dashje (neni 76); Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër (neni 77); Vrasja me paramendim (neni 78); Vrasja për gjakmarrje (neni 78/a); Vrasja në rrethana të tjera cilësuese (neni 79); Vrasja e funksionarëve publikë (neni 79/a); Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit (neni 79/b); Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare (neni 79/c); Vrasja e foshnjës (neni 81); Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike (neni 82); Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme (neni 83).

*Procedime të regjistruara* janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin aktual.

*Procedime për gjykim* janë procedimet për të cilat prokurori i kërkon gjykatës gjykimin e çështjes pasi në përfundim të hetimeve paraprake ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës.

*Procedime të pushuara* janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale.

*Procedime të pezulluara* është vendimmarrja e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

*I pandehur* konsiderohet personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës. Për qëllime statistikore nën këtë term raportohen edhe personat nën hetim.

*Gjendja gjyqësore* nënkupton shënimet në regjistrin e gjendjes gjyqësore lidhur me vendime penale dënimi.

*Përsëritës të së njëjtës veprë penale* konsiderohet personi i cili është dënuar më parë për të njëjtën veprë penale.

*Përsëritës të veprave penale të ndryshme* konsiderohet personi i cili është dënuar më parë për vepra penale të ndryshme nga ajo që akuzohet.

*Person i padënuar* konsiderohet personi ndaj të cilit nuk rezultojnë vendime të mëparshme dënimi.

*Viktimë* është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar si pasojë e një veprë penale.

*I/e rritur* është çdo person mbi 18 vjeç.

*I/e mitur viktimë* është çdo person nën moshën 18 vjeç.

*I mitur në konflikt me ligjin* është çdo person 14-18 vjeç.

## Shtojca II: Tabela

**Tabela 1: Procedime të regjistruara për vrasje**

Procedime të regjistruara	2014	2015	2016	2017	2018
Vrasja me dashje	22,0%	27,0%	24,4%	24,6%	23,4%
Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër	0,5%	0,7%	0,0%	0,8%	0,0%
Vrasja me paramendim	28,2%	22,0%	31,4%	32,0%	36,7%
Vrasja për gjakmarrje	3,8%	2,1%	1,2%	4,1%	0,8%
Vrasja në rrethana të tjera cilësuese	23,9%	19,9%	20,9%	14,8%	19,5%
Vrasja e funksionarëve publikë	2,4%	2,8%	1,2%	0,8%	1,6%
Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	2,4%	5,0%	2,9%	0,8%	3,1%
Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	14,8%	19,9%	15,1%	20,5%	10,9%
Vrasje e foshnjës	0,5%	0,7%	0,0%	0,0%	2,3%
Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike	1,0%	0,0%	2,3%	0,8%	0,0%
Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	0,5%	0,0%	0,6%	0,8%	1,6%
<b>Gjithsej</b>	<b>209</b>	<b>141</b>	<b>172</b>	<b>122</b>	<b>128</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

**Tabela 2: Të pandehur për vrasje**

Vrasje me dashje	2014	2015	2016	2017	2018
Vrasja me dashje	13,9%	18,9%	15,4%	25,2%	21,6%
Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër	0,0%	0,0%	2,1%	1,0%	0,0%
Vrasja me paramendim	30,2%	21,3%	21,5%	14,6%	26,7%
Vrasja për gjakmarrje	4,0%	5,9%	3,1%	1,9%	0,0%
Vrasja në rrethana të tjera cilësuese	28,7%	17,8%	39,0%	17,5%	19,0%
Vrasja e funksionarëve publikë	0,5%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	3,0%	13,6%	1,5%	2,9%	0,0%
Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	18,8%	20,1%	15,9%	32,0%	28,4%
Vrasja e foshnjës	0,0%	0,6%	0,0%	0,0%	0,0%
Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike	0,5%	0,0%	1,0%	1,0%	0,9%
Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme	0,5%	1,8%	0,5%	3,9%	3,4%
<b>Gjithsej</b>	<b>202</b>	<b>169</b>	<b>195</b>	<b>103</b>	<b>116</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

## STATISTIKAT E VRASJEVE NË SHQIPËRI

**Tabela 3: Të pandehur për vrasje sipas moshës dhe gjinisë**

Të pandehur	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Mitur (14 -17 vjeç)</b>	<b>3,0%</b>	<b>0,6%</b>	<b>1,5%</b>	<b>5,8%</b>	<b>2,6%</b>
Vajza	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Djem	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%
<b>Rritur (18+)</b>	<b>97,0%</b>	<b>99,4%</b>	<b>98,5%</b>	<b>94,2%</b>	<b>97,4%</b>
Gra	5,1%	3,0%	1,0%	1,0%	2,7%
Burra	94,9%	97,0%	99,0%	99,0%	97,3%
<b>Gjithsej</b>	<b>202</b>	<b>169</b>	<b>195</b>	<b>103</b>	<b>116</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

**Tabela 4: Viktima të vrasjeve sipas moshës dhe gjinisë**

Viktima	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Mitur (14 -17 vjeç)</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>5</b>
Vajza	0,0%	0,0%	0,0%	33,3%	80,0%
Djem	100,0%	100,0%	100,0%	66,7%	20,0%
<b>Rritur (18+)</b>	<b>79</b>	<b>92</b>	<b>85</b>	<b>57</b>	<b>29</b>
Gra	5,1%	21,7%	17,6%	17,5%	10,3%
Burra	94,9%	78,3%	82,4%	82,5%	89,7%
<b>Gjithsej</b>	<b>82</b>	<b>95</b>	<b>89</b>	<b>60</b>	<b>34</b>

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

**Tabela 5: Të pandehur për vrasje sipas nivelit arsimor dhe punësimit**

Vitet	Niveli arsimor			Punësimi		
	Deri 9 –Vjeçar	Të Mesëm	Të Lartë	Sektor Shtetëror	Sektor Privat	Pa punë
2014	67,3%	29,2%	3,5%	1,2%	37,8%	61,0%
2015	62,5%	36,7%	0,8%	1,4%	37,8%	60,8%
2016	62,3%	37,1%	0,6%	0,7%	36,2%	63,2%
2017	54,8%	44,2%	1,0%	0,0%	41,7%	58,3%
2018	53,6%	43,8%	2,7%	1,1%	37,9%	60,9%

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme



# ÇMIMET E KONSUMIT NË SHQIPËRI

Hazbi Bunguri, Instituti i Statistikave  
hbunguri@instat.gov.al

Ilirjana Kraja, Instituti i Statistikave  
ikraja@instat.gov.al

Jesmína Shahini, Instituti i Statistikave  
jmustafaj@instat.gov.al

## Abstrakt

Çmimet e të mirave dhe shërbimeve ndikojnë direkt ose indirekt në të gjitha fushat e shoqërisë, po ashtu edhe në sjelljen e konsumatorëve. Qëndrueshmëria e çmimeve është e rëndësishme për qëndrueshmërinë në ekonomi. Një nga objektivat kryesore të politikës monetare është stabiliteti i çmimeve. Në një mjedis inflacionist, çmimet kanë prirje të ndryshojnë në mënyrë të paparashikueshme, diçka që mund t'u shkaktojë humbje të konsiderueshme njerëzve.

Në këtë artikull informues mbi çmimet e konsumit në Shqipëri do të paraqiten llojet e treguesve që shërbejnë për matjen e normës së inflacionit, si edhe trendet e niveleve të çmimeve në vendin tonë. Matësi zyrtar i normës së inflacionit në vend është indeksi i çmimeve të konsumit. Mund të themi që ky tregues ka qenë i qëndrueshëm gjatë 20-vjeçarit të fundit.

## Fjalë kyçe:

Indeksi i Çmimeve të Konsumit; Norma e inflacionit;  
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

### 1. HYRJJE

Çmimi është sasia e parave që një blerës i paguan një shitësi për blerjen e një sasive të caktuar malli ose shërbimi, ose vlera e një malli ose shërbimi të rënë dakord për një transaksion. Transaksionet realizohen midis aktorëve të ndryshëm, si për shembull konsumatorët individualë, familjet, ndërmarrjet, vendet. Në këtë mënyrë formohet një sistem çmimesh i cili ka ndikim në pothuajse të gjitha fushat e shoqërisë, përcakton sjelljen e konsumatorit, shpërndarjen e burimeve, politikat financiare dhe ekonomike të një vendi, etj.

Në sajë të këtyre karakteristikave të çmimeve, dhe veçanërisht për shkak të ndikimit të tyre shumë të rëndësishëm, statistikave të çmimeve në Shqipëri llogaritin tregues të ndryshëm për monitorimin e lëvizjeve të çmimeve jo vetëm në kohë, nëpërmjet llogaritjes së indekseve të ndryshme të çmimeve, por edhe në hapësirë, si në vlerë absolute (çmimet mesatare) ashtu edhe në kuptimin relativ (pariteti i fuqisë blerëse).

Të dhënat e para për çmimet në vlerë absolute në Shqipëri kanë filluar në vitin 1924, me hapjen e zyrës statistikore që mbante evidenca të ndryshme ekonomike pranë Ministrisë Botërore dhe të Bujqësisë. Të dhëna më të plota për çmimet në vlerë absolute janë prodhuar me krijimin e sistemit statistikor në shtetin shqiptar në vitin 1945 me krijimin e Drejtorisë së Statistikës të atashuar pranë Këshillit të Ministrave. Ndjekja e ecurisë në kohë e çmimeve në Shqipëri ka filluar në vitin 1991 me llogaritjen e indeksit të parë zyrtar të Çmimeve të Konsumit nga Instituti i Statistikave. Në këtë artikull do të pasqyrojmë ecurinë e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të konsumit vitet e fundit në Shqipëri, duke përfshirë edhe një krahasim me vendet e tjera, veçanërisht vendet fqinje.

### 2. INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Ecuria e çmimeve të konsumit realizohet nëpërmjet Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK). Indeksi i parë zyrtar në Shqipëri u llogarit në dhjetor 1991, duke pasur si periudhë bazë muajin dhjetor 1990. Në vitin 1991, Drejtorja e Përgjithshme e Statistikave llogariti gjithashtu indeksin e çmimeve për muajin dhjetor 1989 dhe dhjetor 1990. Nga viti 1992 e në vazhdim është llogaritur Indeksi i Çmimeve të Konsumit me frekuencë mujore. Në vitin 1993, Instituti i Statistikave (INSTAT) realizoi për herë të parë Anketën e

Buxhetit të Familjes (ABF) në zonën urbane, rezultatet e të cilës u përdoren për përditësimin e shportës dhe llogaritjen e peshave të mallrave të përzgjedhura për llogaritjen e indeksit. Muaji dhjetor 1993 u përdor si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit. Shporta e mallrave përmbante 221 artikuj dhe shpenzimet u klasifikuan të ndara në 8 grupe kryesore. Në vitin 2000 INSTAT realizoi ABF në të gjithë territorin e vendit, rezultatet e të cilës u përdorën për përditësimin e shportës dhe peshave të mallrave dhe shërbimeve të shportës. Indeksi u llogarit duke përdorur muajin dhjetor 2001 si periudhë bazë. Shporta përmbante 267 artikuj dhe shpenzimet për herë të parë u klasifikuan në 12 grupe kryesore, të përputhshme me klasifikimin e shpenzimeve sipas qëllimit (COICOP). Duke filluar nga viti 2015, INSTAT përditëson shportën dhe peshat e mallrave dhe shërbimeve të shportës çdo vit. Shporta e fundit përmban 331 artikuj të klasifikuar sipas klasifikimit E-COICOP 2000.

#### 2.1 Shpenzimet e familjeve

Shpenzimet e familjeve janë baza për krijimin e shportës dhe peshave në IÇK. Këto shpenzime mund të ndahen në tre grupe kryesore:

- Në grupin e parë përfshihen shpenzimet e konsumit (82,2 %);
- Në grupin e dytë përfshihen shpenzimet për banesë (10,9 %);
- Në grupin e tretë shpenzime të tjera (6,9 %). Shpenzimet e konsumit në vitin 2017 ishin rreth 73.400 lekë për NJEF (familje me 3,7 persona), ku shumica e këtyre shpenzimeve përdorëshin për ushqime dhe pije joalkoolike, pasuar nga shpenzimet për qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji, etj.

Shpërndarja e shpenzimeve të familjeve, së bashku me çmimet e mbledhura për produktet e zgjedhura, janë burimi bazë për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK). Indeksi përdoret për matjen e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të kryera nga popullsia rezidente të territorin e Repulikës së Shqipërisë.


Sjellja konsumatore e familjeve ka ndryshuar ndjeshëm dhe këto ndryshime janë reflektuar në strukturën e shportës së përdorur për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit. Shpenzimet mesatare për konsum të një individi vlerësohen të jenë 19.660 lekë në muaj, nga të cilat 8.664 lekë për konsum ushqimor dhe 10.996 lekë për konsum jo-ushqimor.

Tabela 1: Produktet e shportës për llogaritjen e IÇK

		2001	2018
	Gjithsej	267	332
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	90	101
2	Pije alkoolike dhe duhan	6	6
3	Veshje dhe këpucë	40	40
4	Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji	13	13
5	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	38	42
6	Shëndeti	8	12
7	Transporti	15	20
8	Komunikimi	4	8
9	Argëtim dhe kulturë	26	36
10	Shërbimi arsimor	4	7
11	Hotele, kafene dhe restorante	13	19
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	10	27

Burimi: INSTAT

Grafiku 1: Struktura e grupet kryesore të IÇK (2001 dhe 2018)



Burimi: INSTAT

Ndryshimi në konsumin e familjeve reflektohet në uljen e shpenzimeve për mallra dhe rritjen e shpenzimeve për shërbime. Struktura e shpenzimeve për grupin “ushqime dhe pije alkoolike” në vitin 2001 është 42,6%, duke arritur në 39,3 % në vitin 2018, siç paraqiten në grafikun 1. Aktualisht peshën më të lartë në shportë për llogaritjen e IÇK-së e kanë shpenzimet për ushqim dhe pije joalkoolike, e ndjekur nga shpenzimet e transportit (15,0 %) dhe shpenzimet për qira, ujë lëndë djegëse dhe energji (16,3%).

## 2.2 Inflacioni dhe inflacioni i pritshëm

Inflacioni është rritja e përkohshme e të gjitha ose disa çmimeve të mallrave dhe shërbimeve për një periudhë kohe, i cili ul vlerën e parasë ose fuqinë blerëse. Inflacioni, nga një këndvështrim i përgjithshëm, është thjesht një “superprodhim” i parasë, i cili në njërin anë, në mënyrë të dukshme rrit çmimet e mallrave, dhe në anën tjetër ul fuqinë blerëse të parasë. Në një gjuhë më të thjeshtë mund të thuhet se inflacioni ndodh atëherë kur niveli i përgjithshëm i çmimeve dhe i kostove në ekonomi rritet, domethënë kur rritet çmimi i bukës, i naftës, i veturave etj., ose kur rritet niveli i pagave, çmimi i tokës etj. Është normale që rritja e çmimeve të mos jetë në të njëjtin nivel dhe të njëjtën kohë në të gjithë mallrat e përmendur më sipër. Në këtë kuptim, si periudhë inflacioniste do të përkufizojmë atë periudhë kohe kur niveli i çmimeve të konsumit – i matur nga ndryshimi i një indeksi të çmimeve të konsumit – rritet në përgjithësi. Që nga viti 1993, matësi zyrtar i inflacioni në Shqipëri është Indeksi i Çmimeve të Konsumit.


Tabla 2: Inflacioni në Shqipëri, 1989 -2019

Inflacioni më i lartë (Dhjetor 1997)	42,1%
Inflacioni më i ulët (Dhjetor 1999)	-1,0%
Vjetor (Dhjetor 2018)	1,8%

Burimi: INSTAT

Në vitin 2018, rritja vjetore e çmimeve e matur nga indeksi i çmimeve të konsumit ishte 1,8 %, siç paraqitet në tabelën 2, ndërsa rritja mesatare vjetore ishte 2,0 %.

Grafik 2: Norma mesatare vjetore e inflacioni në vite



Burimi: INSTAT

**Inflacioni = Paguaj vitin që vjen me pagën e vitit të kaluar.**

## ÇMIMET E KONSUMIT NË SHQIPËRI

Inflacioni i perceptuar, shpesh ndryshon nga inflacioni zyrtar i llogaritur.

Rritja e çmimeve tërheq më shumë vëmendjen e mediave sesa rënia e tyre; blerjet e shpeshta, si për shembull blerjet me para në dorë, janë më të dallueshme sesa blerjet më pak të shpeshta dhe debitë direkte. Gjithashtu, një strukturë konsumi e një personi mund të ndryshojë shumë nga struktura e konsumit mesatar të konsumatorit.

Llogaritja zyrtare e normës së inflacionit mund të shpjegohet në disa mënyra. Një nga këto mënyra është indeksi i blerjeve të shpeshta, i cili mat ndryshimet në çmimet e mallrave dhe shërbimeve të cilat blihen shpesh dhe paguhet me para në dorë. Ndryshimet në çmimet e këtyre mallrave perceptohen më lehtë nga konsumatorët.

Lëvizja e inflacionit të perceptuar tregon se njerëzit shpesh ndiejnë se çmimet u rriten shumë më tepër sesa rritja reale; kjo ndodh më shpesh në parashikimin e rritjes së çmimeve ose gjatë kohës së krizës ekonomike, si edhe disa ndryshimeve të tjera si për shembull efekti i përdorimit të monedhës euro në vendet e ndryshme.


të dhënat e Vrojtimit të Buxhetit të Familjeve të kryer nga INSTAT. Këto të dhëna janë plotësuar dhe kontrolluar me të tjera burime statistikore dhe jo statistikore, kryesisht me të dhënat e Llogarive Kombëtare.

**Çdo vit çmimet e larta të ushqimeve dhe pijeve alkoolike kanë ndikuar kryesisht në rritjen e normës së inflacionit.**

**Tabela 3: Çmimet mesatare vjetore të shitjes me pakicë të disa produkteve ushqimore, Shqipëri**

Produkti	Dhjetor 1992	2005	2010	2018
Oriz, 1 kg	70.5	74.0	159.3	151.1
Miell, 1kg	24.7	61.2	79.5	89.7
Bukë, 1kg	.....	64.4	87.0	109
Makarona, 1 kg	75.4	115.1	186.1	172.1
Mish viçi, 1 kg	144.4	639.7	736.0	788.1
Mish pule 1, kg	147.9	241.6	309.1	348.6
Qumësht i freskët, 1 liter	19.5	58.2	89.0	110.4
Veçë, 1 kokërr	9.4	11.2	11.1	14.9
Gjalpë, 1 kg	197	470.7	540.5	573.5
Vaj vegjetal, 1litër	103.8	142.3	182.3	165.1
Mollë, 1 kg	32.2	110	109.7	106.2
Patate, 1kg	22.1	48	60.9	60.3
Sheqer, 1 kg	57.5	63.2	117.5	76.5
Paketë cigare, 1 paketë	49	100.4	148.8	246.9

**Grafiku 3: Kontributi i grupeve individuale të IÇK**



Burimi: INSTAT

Në vite të ndryshme, grupe të veçanta të IÇK kontribuojnë në mënyra të ndryshme në normën totale të inflacionit, siç paraqitet në tabelën 2, në vartësi të peshës që grupet e shpenzimeve kanë dhe në varësi të ndryshimit të çmimeve të grupit.

Duke filluar nga viti 2015, peshat e grupeve kryesore të shpenzimeve janë ndryshuar çdo vit bazuar kryesisht në

Burimi: INSTAT

**Deri në Dhjetor të vitit 1992 çmimi i bukës akoma nuk ishte liberalizuar.**

Çmimet e mishit të viçit dhe qumështit të freskët janë rritur shumë krahasuar me ato të dhjetorit 1992. Me paratë që shpenzon një individ për blerjen e një kilogrami mishi viçi apo 1 litër qumështi të freskët në vitin 2018, mund të blije 5 kilogramë mish apo 5 litra qumësht në dhjetor të vitit 1992.

Çmimi i një pakete cigare është rritur shumë që nga viti 1992. Me shumën e parave që një individ shpenzonte për blerjen e një pakete cigare në vitin 2018, në dhjetor të vitit 1992 mund të blije 5 paketa cigare.

Çmimi i një pakete cigare dhe i një kilogrami orizi në vitin 2018 është dyfishuar, krahasuar me çmimet e vitit 2005.

**Tabela 4: Çmimet mesatare vjetore të shitjes me pakicë të karburantit, Shqipëri**

	2003	2005	2010	2015	2018
Eurodizel, 1 litër	73.7	103.4	143.3	171.4	164.6
Benzinë, 1 litër	109.1	121.0	136.2	173.9	168.6

Burimi: INSTAT

Në vendin tonë, tendencat e çmimeve të produkteve të naftës kryesisht varen nga tendencat e çmimeve të naftës në tregun global.

### 3. INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT (IHÇK)

Monitorimi i tendencave të çmimeve dhe sigurimi i stabilitetit të çmimeve jo vetëm në një vend, por edhe më gjerë realizohet nëpërmjet Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synon për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar normën e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës, dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Në Shqipëri IHÇK është llogaritur dhe publikuar si një indikator i pavarur që nga muaji janar 2017 bazuar në:

1. Rregulloren e KE Nr 2494/95
2. Ligjin Nr 9180 dt.05.02.2004, për “Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar
3. Programin e Statistikave Zyrtare, 2017-2021.

Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së Klasifikimit Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore. ECOICOP është klasifikimi i shpenzimeve i përdorur nga EUROSTAT. Periudha referuese e çmimeve është muaji dhjetor 2017, ndërsa periudha referuese e indeksit është muaji dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100).

#### 3.1 Dallimet IÇK-IHÇK

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë hartuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguara për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit me dallimet si më poshtë:

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri
- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- *Mbulimi i produkteve*

- IÇK përmban 331 produkte
- IHÇK përmban 329 produkte

- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*

- Në IÇK mbulohe vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
- IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.


- *Peshat*

- Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
- Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

### 3.2 Inflacioni i matur nga IHÇK

Në muajin dhjetor 2018 rritja vjetore e matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit ishte 1,8 % nga 1,7 % që ishte në BE.

Grafiku 4: Ndryshimi vjetor i IHÇK sipas shteteve, dhjetor 2018



Burimi: Eurostat, INSTAT

#### 4. FUQIA BLERËSE DHË TREGUESIT E MAËTJES SË BARAZISË SË FUQISË BLERËSE

Paritetet e Fuqisë Blerëse (PFB) janë tregues të dallimeve të nivelit të çmimeve ndërmjet vendeve. Ato tregojnë se sa njësi monetare kushton një sasi e caktuar mallrash dhe shërbimesh në vende të ndryshme. PFB-të mund të përdoren si norma konvertimi të monedhës për të kthyer shpenzimet e shprehura nga monedha kombëtare në një monedhë artificiale të përbashkët (Standardi i Fuqisë Blerëse, SFB), duke eliminuar në këtë mënyrë efektin e dallimeve të nivelit të çmimeve në të gjitha vendet.

PFB është treguesi më i përdorur për të krahasuar Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) të vendeve të ndryshme të zhveshur nga efekti i ndryshimit të niveleve të çmimeve. Ky tregues përfaqëson potencialin ekonomik, zhvillimin dhe standardin e jetesës së rezidentëve të një vendi.

**PFB = një monedhë artificiale, fiktive e cila në nivel BE-28 është e barabartë me 1 Euro**

Tabela 5: PBB për frymë në PFB, Indeksi i volumit, në vendet evropiane


	2010	2015	2016	2017	2018
BE (28 shtetet)	100	100	100	100	100
Belgjikë	120	118	118	116	115
Bullgari	44	47	48	49	50
Republika Çeke	83	87	88	89	90
Danimark	129	127	126	128	126
Gjermani	120	124	124	124	123
Estoni	65	76	77	79	81
Irlandë	130	178	177	181	187
Greqi	84	69	68	67	68
Spanjë	96	91	91	92	91
Francë	108	105	104	104	104
Kroaci	59	59	61	62	63
Itali	104	95	97	96	95
Qipro	100	82	84	85	87
Letoni	53	64	64	67	70
Lituani	60	75	75	78	81
Luksemburg	257	266	260	253	254
Hungari	65	68	67	68	70
Maltë	83	92	94	98	98
Holandë	135	130	128	128	129
Austri	126	129	128	127	127
Poloni	62	69	68	70	71
Portugali	82	77	77	77	76
Rumani	51	56	59	63	64
Sloveni	83	82	83	85	87
Slovaki	74	77	77	76	78
Finlandë	116	109	109	109	110
Suedi	125	125	122	121	121
Mbretëria e Bashkuar	108	109	107	106	104
Islandë	119	126	131	130	133
Norvegji	174	156	145	146	150
Zvicër	159	165	160	156	157
Mal i Zi	41	42	44	45	47
Maqedoni	34	36	37	36	38
<b>Shqipëri</b>	<b>29</b>	<b>30</b>	<b>30</b>	<b>30</b>	<b>31</b>
Serbi	36	36	37	39	40
Turqi	52	67	66	66	65
Bosnje dhe Hercegovina	29	30	31	31	31

Burimi: Eurostat

**Në vitin 2018 Luksemburgu është shteti me PBB për frymë më të lartë në Europë 254 % (BE-28 =100).**

## ÇMIMET E KONSUMIT NË SHQIPËRI


**Grafiku 5: Indeksi i niveleve të çmimeve për grupet e zgjedhura të produkteve dhe shërbimeve; Shqipëria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, 2017**



Burimi: Eurostat

Krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka indeksin e nivelit të çmimeve më të ulët në grupet “Hotele dhe restorante” dhe “Pajisje të transportit personal”.

**Grafiku 6: Indeksi i niveleve të çmimeve për grupet e zgjedhura të produkteve ushqimore; Shqipëria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, 2017**



Burimi: Eurostat

Në vitin 2018, Shqipëria ka nivelin më të lartë të çmimit për produktet mish dhe qumësht e vezë sesa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, respektivisht 71,0% dhe 94,0%. Zvicra ka nivelin më të lartë të çmimeve në Evropë për produktin e mishit me 228,0%. Për produktet bukë, pije alkoolike dhe duhan, Mali i Zi është vendi me çmimet më të larta në Ballkanin Perëndimor. Norvegjia është vendi me indeksin

më të lartë të çmimit, me 136,0% dhe Mali i Zi me indeksin më të ulët, 57,0%.



### 5. KONKLUZIONE

Stabiliteti i çmimeve është një nga tregues kryesorë për ekonominë e një vendi. Treguesit kryesorë për matjen e saj janë Indeksi i Çmimeve të Konsumit dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit. Indeksi i Çmimeve të Konsumit është matësi zyrtar i inflacionit në vend. Gjatë 20-vjeçarit të fundit, ky tregues ka qenë përgjithësisht stabël. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar

normën e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës, dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane, duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Paritetet e Fuqisë Blerëse janë përcaktuar si deflator dhe konvertues monedhe, të cilët eliminojnë efektet e diferencave në nivelin e çmimeve ndërmjet vendeve. PFB-të kanë dy funksione; funksionin e deflatorit të çmimeve dhe funksionin konvertues të monedhës në disa monedha të përbashkëta. Kur vendet kanë një monedhë të përbashkët, PFB-të kanë vetëm funksionin e parë, si deflator çmimesh.

### REFERENCA

- [1] Consumer Price Index manual, Concepts and Methods: <https://www.imf.org/en/Data/Statistics/cpi-manual>
- [2] Eurostat-OECD Methodological Manual on Purchasing Power Parities: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-manuals-and-guidelines/-/KS-RA-12-023>
- [3] Harmonised Index of Consumer Prices (HICP), Methodological Manual; <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/9479325/KS-GQ-17-015-EN-N.pdf/d5e63427-c588-479f-9b19-f4b4d698f2a2>; <https://ec.europa.eu/eurostat/web/hicp/data/database>
- [4] PPP Statistics Database. Luxembourg: European Commission, EUROSTAT: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/purchasing-power-parities/data/database>; <https://ec.europa.eu/eurostat/web/purchasing-power-parities/overview>
- [5] Publikimet e Indeksit të Çmimeve të Konsumit: <http://instat.gov.al/al/temat/çmimet/indeksi-i-çmimeve-të-konsumit/#tab3>
- [6] Publikimet e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit: <http://instat.gov.al/al/temat/çmimet/indeksi-i-harmonizuar-i-çmimeve-të-konsumit/#tab3>
- [7] Publikimet e Paritetit të Fuqisë Blerëse: <http://instat.gov.al/al/temat/çmimet/paritetet-e-fuqisë-blerëse/#tab3>

# OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

## SFIDAT E ZBATIMIT TË AGJENDËS 2030

Vjollca Simoni, Instituti i Statistikave  
vsimoni@instat.gov.al

### Abstrakt

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), nën Agjendën 2030, janë një grup prej 17 qëllimesh të cilat janë dakordësuar unanimisht në nivel global nga të gjithë drejtuesit e nivelit të lartë të vendeve, në një samit historik të Kombeve të Bashkuara (KB), në vitin 2015. Qëllimi i këtyre objektivave është krijimi i një të ardhmeje më të mirë dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për njerëzimin.

Të gjitha vendet nënshkruan individualisht marrëveshjen për arritjen e këtyre qëllimeve. Qeveria shqiptare e nënshkroi atë në shtator 2015, duke u angazhuar, si të gjitha vendet e tjera, për zbatimin e kësaj agjende. Por a do të jenë vendet në gjendje të prodhojnë të dhënat e nevojshme për zbatimin e agjendës brenda vitit 2030 sipas përcaktimit të KB, apo do të ketë nevojë për kombëtarizim dhe priorizim të treguesve?!

Targetet e vendosura, të cilat janë 169, adresojnë sfidat globale me të cilat përballet sot njerëzimi siç janë varfëria, pabarazia, ndryshimet klimatike, degradimi i mjedisit, paqja dhe drejtësia.

Ky artikull shërben për të informuar për OZHQ-në, Agjendën 2030, rëndësinë, statusin, sfidat dhe nevojën e kombëtarizimit të OZHQ-ve.

### Fjalë kyçe:

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm; Treguesit; Targetet

## 1. HYRJE

Çfarë është unike për Agjendën 2030 është se ajo zbatohet dhe kërkon veprime nga të gjitha vendet, qofshin ato të varfëra apo të pasura. Për të zbatuar Agjendën 2030 është i nevojshëm prodhimi i më shumë statistikave në përputhje me metodologjinë e Kombeve të Bashkuara. Vendet duhet të vlerësojnë disponueshmërinë e treguesve në nivel vendi sipas klasifikimit të niveleve. Treguesit klasifikohen në tre nivele, në bazë të zhvillimit metodologjik dhe disponueshmërisë së të dhënave në nivel global.

Niveli i parë: Treguesi është konceptualisht i qartë; ka standarde, metodologji të caktuar ndërkombëtare, të dhënat prodhohen rregullisht nga të paktën 50 përqind të vendeve dhe të popullsisë në ato rajone ku treguesi është i rëndësishëm.

Niveli i dytë: Treguesi është konceptualisht i qartë; ka standarde, metodologji të caktuar ndërkombëtare, por të dhënat nuk prodhohen rregullisht nga vendet.

Niveli i tretë: Metodologjia apo standardet ndërkombëtare nuk janë akoma të disponueshme për treguesin, por ato janë duke u zhvilluar (ose do të zhvillohen) ose testohen.

Ekzistojnë një sërë treguesish të ndryshëm për OZHQ-në, statistikorë dhe jostatistikorë, prandaj metodat se si prodhohen dhe maten këta tregues ndryshojnë. Metodologjia e përdorur për prodhimin e treguesve të OZHQ-ve ndikon drejtpërdrejt dhe në arritjen e tyre.

Sigurimi i të dhënave për treguesit e OZHQ-ve dhe modelet e rrjedhës së të dhënave (data flow) duhet të merren në konsideratë në nivele të ndryshme; nivele globale, rajonale, kombëtare, nënkombëtare dhe tematike.

Në nivelin kombëtar ka disa skenarë të mundshëm për rrjedhën e të dhënave që varen nga struktura dhe niveli i zhvillimit të sistemit statistikor në vend: i centralizuar, i decentralizuar ose një kombinim i të dyjave. Një nga rekomandimet për OZHQ-të, publikuar nga UNECE, është modeli 1, ku thuhet që Instituti Kombëtar i Statistikave të jetë koordinator i të gjithë treguesve të OZHQ-ve.

Meqenëse të dhënat prodhohen nga ministritë e linjës, institucione apo agjencitë e Kombeve të Bashkuara përgjegjëse për objektiva të caktuara, është e rëndësishme krijimi i një qendre të të dhënave që të jetë përgjegjëse

për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave përpara se ato të publikohen apo përcillen në Kombet e Bashkuara, duke siguruar kështu cilësinë e të dhënave.

Rezoluta e Kombeve të Bashkuara riafirmon rolin e Instituteve Kombëtare Statistikore dhe Sistemeve Kombëtare Statistikore në zbatimin e Agjendës 2030, si dhe thekson rëndësinë e ngritjes së kapaciteteve statistikore.

Agjenda 2030 për OZHQ-në përfshin 232 tregues, një numër që mund të ndryshojë me tregues shtesë ose zëvendësim të atyre aktual për shkak të specifikave të vendit. Në Shqipëri, duke pasur parasysh natyrën politike të vendit tonë, disa nga treguesit mund të mos jenë të rëndësishëm. Kjo sjell nevojën e zëvendësimit të disa treguesve të caktuar. Për të arritur këtë, së pari Shqipëria duhet të bëjë një vlerësim të treguesve, duke identifikuar institucionin përgjegjës dhe disponueshmërinë e treguesve, i cili do të sigurojë një pasqyrë të qartë të situatës. Shumica e vendeve tashmë kanë filluar ta bëjnë këtë ushtrim duke identifikuar treguesit që do të zëvendësohen ose kombëtarizohen. Edhe pse kjo mund të sjellë një hendek sa i përket krahasimit të të dhënave midis vendeve, kombëtarizimi i treguesve është alternativa më e mirë për zbatimin e Agjendës 2030.

Janë vlerësuar disa mundësi për të gjetur mënyrën më të mirë për të zbatuar plotësisht OZHQ-të në përputhje me kërkesat e Kombeve të Bashkuara të dakordësuara globalisht. Për këtë qëllim, vëmendje e madhe iu është dhënë dhe organizimit të takimeve të shumta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, teknike dhe politike për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të shkëmbyer përvojat e vendeve gjatë zbatimit të Agjendës 2030. Të gjitha vendet janë të përkushtuara që të bëjnë përpjekjet e tyre për arritjet e qëllimeve, por duke parë specifikat e vendit dhe përparësitë, nevojën për të kombëtarizuar të dhënat, është e pashmangshme si edhe thelbësore për të prodhuar të dhënat e nevojshme duke mos "lënë askënd pas".

Shqipëria është angazhuar për zbatimin e Agjendës 2030 dhe që nga marrëveshja e nënshkruar nga qeveria në vitin 2015 janë ndërmarrë disa veprime.

## 2. PIKA HISTORIKE E OZHQ NË SHQIPËRI


### 2.1 Nga Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri te Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Agjenda e zhvillimit të qëndrueshëm vazhdoi aty ku përfunduan Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM). Shqipëria arriti sukses të konsiderueshëm në zbatimin e Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Duke treguar përkushtim për vazhdimin e procesit gjatë vitit 2014 - 2015, Shqipëria së bashku me Indonezinë, Ruandën, Tunizinë dhe Mbretërinë e Bashkuar morën pjesë në një iniciativë pilot të organizuar nga UNDP për Objektivin 16 - Paqe dhe Drejtësi, Institucione të forta. Qëllimi i këtij piloti ishte integrimi i këtyre qëllimeve dhe objektivave në procesin e planifikimit kombëtar.

Qeveria shqiptare, për të mbështetur zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, ka krijuar dy struktura kryesore që udhëheqin procesin e zbatimit të OZHQ-ve në Shqipëri:

- Komiteti Ndërmintor për OZHQ-të, i cili kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe përfshin institucionet qeveritare, palët e interesuara nga komuniteti i biznesit, shoqëria civile, academia dhe organizatat ndërkombëtare, me mbështetjen teknike të ofruar nga Departamenti i Zhvillimit dhe Qeverisjes së Mirë në zyrën e Kryeministrit.
- Grupet ndërmintore teknike të punës ku ministritë e linjës dhe INSTAT janë pjesë e tij.

Figura 1: Strukturat për ndjekjen e procesit të zbatimit të OZHQ-ve në Shqipëri



## OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM SFIDAT E ZBATIMIT TË AGJENDËS 2030

Koordinimi dhe “mbarëvajtja” e procesit drejtohet nga Komiteti Ndërmintor i OZHQ. Në kuadër të mbështetjes në nivele të larta të Agjendës 2030, Parlamenti i Shqipërisë në vitin 2018 ka miratuar një rezolutë që konfirmon angazhimin e vendit për këtë agjendë.

Qeveria shqiptare, e cila nënshkroi angazhimin për Agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, është përqendruar në zbatimin e OZHQ në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe në procesin e Integritimit Evropian. Prioriteti dhe ambicia strategjike e qeverisë shqiptare si vend kandidat është aderimi në Bashkimin Evropian (BE).

Shqipëria ka përgatitur një raport bazë (Baseline Report) për OZHQ-të, i cili specifikon se 140 objektiva OZHQ (83,0 %) lidhen drejtpërdrejt me komponentë specifike të shtyllave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimi 2015-2020. Lidhjet midis synimeve të politikës së Shqipërisë dhe objektivave të OZHQ në strategjitë kombëtare dhe dokumentet e politikave përshkruajnë 134 objektiva OZHQ (79,0 %), të lidhura me objektivat specifike të kornizës kombëtare të politikave strategjike.

Për të arritur OZHQ në Shqipëri brenda vitit 2030, kërkohet një angazhim dhe bashkëpunim i jashtëzakonshëm midis të gjithë aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Në zbatim të Agjendës 2030, qeveria shqiptare u angazhua të përgatisë Raportin Vullnetar Kombëtar i cili u prezantua në Forumin e Nivelit të Lartë Politik në Nju Jork në korrik 2018.

Raporti Vullnetar Kombëtar synon lehtësimin dhe shkëmbimin e përvojave, përfshirë sukseset, sfidat dhe mësimet e marra, me qëllim përshpejtimin e zbatimit të Agjendës 2030. Raporti Vullnetar Kombëtar gjithashtu kërkon të forcojë politikat dhe institucionet qeveritare dhe të mobilizojnë mbështetje dhe partneritete shumëpalëshe për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Instituti i Statistikave në Shqipëri vullnetarisht përgatiti një aneks statistikor i cili shoqëroi raportin.

Në raportin fillestar, disponueshmëria e treguesve globalë për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri është si më poshtë:

- Numri i synimeve të OZHQ-ve me të paktën një tregues të disponueshëm të gatshëm në Shqipëri 62 ose 37,0 %
- Numri i synimeve të OZHQ-ve me të paktën një tregues të disponueshëm me përpjekje në Shqipëri 13 ose 8,0 %
- Numri i synimeve të OZHQ-ve me të paktën një tregues pjesërisht të disponueshëm në Shqipëri 17 ose 10,0 %
- Numri i synimeve të OZHQ-ve pa tregues të disponueshëm në Shqipëri 77 ose 46,0 %

Tabela 1: Disponueshmëria e treguesve globalë për objektivat e OZHQ-ve në Shqipëri



Shënim: Not available – Nuk janë të disponueshëm

Not applicable – Nuk janë të aplikueshëm për Shqipërinë

Për sa i përket qëllimeve specifike, tabela e mësipërme tregon se 32,0% e treguesve nga korniza e treguesve globalë janë në dispozicion në Shqipëri, 24,0 % është ose mund të jetë në dispozicion me përpjekje ose pjesërisht e disponueshme, 39,0 % aktualisht nuk janë në dispozicion dhe 6,0 % nuk janë të zbatueshme për Shqipërinë.

Një nga përfundimet tregon se jo të gjithë treguesit mund të jenë të rëndësishëm për një vend, gjë që konfirmon përsëri nevojën për kombëtarizimin e treguesve.

Instituti i Statistikave në Shqipëri, duke ndjekur praktikat më të mira të vendeve të tjera, në vazhdim të përpjekjeve me përgatitjen e aneksit statistikor i cili shoqëroi Raportin Vullnetar Kombëtar, ka publikuar në vitin 2018 një botim të OZHQ-ve me tregues statistikorë të disponueshëm në vendin tonë. Ky publikim do të vazhdojë të botohet në bazë vjetore. Gjithashtu, me mbështetjen e UNDP-së në Shqipëri, INSTAT ka krijuar një Platformë të OZHQ-ve që

gjendet në faqen zyrtare të INSTAT i cili tregon treguesit e disponueshëm.

### 3. KOMBËTARIZIMI I TREGUESVE TË OZHQ-VE

Të gjitha vendet janë të angazhuara për prodhimin e treguesve të nevojshëm për zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Zyrat Statistike Kombëtare në të gjithë vendet kanë role dhe qasje të ndryshme në varësi se si qeveria e tyre i përfshin ato në proces. Ky proces është politik dhe kështu në shumicën e vendeve është i koordinuar nga nivelet e larta politike, si Zyra e Kryeministrit në rastin shqiptar, Presidenca në rastin Meksikan, Ministria e Punëve të Jashtme në Bjellorusi, etj.

Prioritizimi i OZHQ-ve në nivel vendi është një detyrë shumë sfiduese dhe komplekse, për shkak të rrezikut të mundshëm për të lënë disa fusha mënjanë, por edhe

komplekse pasi disa objektiva ose qëllime mund të mos jenë të rëndësishme në të njëjtën mënyrë për të gjitha vendet.

Në këtë drejtim, një përparësi prioritare e OZHQ-ve bazohet në kontrollin e objektivave që nuk janë të zbatueshme për Shqipërinë, duke zvogëluar numrin e përgjithshëm në 148.

Në rastin e Shqipërisë, një mënyrë për të prioritzuar OZHQ-të, është përafrimi i tyre me politikat specifike kombëtare, por me elementin thelbësor që kjo politikë duhet të jetë vërtetë prioritet kombëar.

Deri më sot, përparësitë e qeverisë të cilat janë edhe pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, janë si në vijim; Shërbimet Publike Inovative dhe të përqendruara tek qytetarët (Mirëqeverisja), Rimëkëmbja dhe konsolidimi financiar i sektorit të energjisë (Energjia); Nxitja e inovacionit dhe konkurrencës (Investimet e Huaja Direkte dhe investimet vendase); Menaxhimi i integruar i ujit; Menaxhimi i integruar i tokës; dhe Reforma strukturore financiare.

Një tjetër prioritet kryesor që duhet të përdoret si mundësi për të prioritzuar dhe për të prodhuar tregues për OZHQ-të është procesi i Integritimit Evropian, ku qeveria shqiptare po punon me vendosmëri për të zbatuar Rekomandimet e Komisionit Evropian të muajit prill 2018 për çeljen e negociatave ku janë identifikuar pesë fusha si prioritare në këtë proces:

- Reforma në administratën publike, institucione të qëndrueshme dhe moderne, shërbimi civil profesional dhe i depolitizuar
- Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së institucionet gjyqësore
- Rritja e luftës kundër korrupsionit
- Rritja e luftës kundër krimit të organizuar
- Sigurimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e pronës

## **4. SFIDAT PËR ZBATIMIN OZHQ-VE**

Zbatimi i Agjendës 2030 për OZHQ-të kërkon maksimizimin e përpjekjeve.

Objektivat e unifikuar globale të nivelit të lartë kërkojnë përgjigje globale dhe rajonale. Zbatimi i Agjendës 2030 kërkon mbështetje dhe veprim politik, ekspertizë dhe burime financiare dhe njerëzore.

## **5. KONKLUZIONE**

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, të njohur gjithashtu si Qëllimet Globale, u miratuan nga të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015 si një thirrje universale për të marrë masa për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet deri në vitin 2030.

17 Objektivat janë të integruara, pra ato e pranojnë që veprimi në një fushë do të ndikojë dhe në rezultatet e fushave të tjera dhe se zhvillimi duhet të balancojë qëndrueshmërinë sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Nëpërmjet premtimit “Për të mos lënë askënd pas”, vendet janë zotuar të fokusohen për të përparuar në ato fusha që janë më pak të zhvilluara. Kjo është arsyeja pse OZHQ-të janë krijuar për të sjellë ndryshime në botë në disa “fusha” që ndryshojnë jetën, duke përfshirë zhdukjen e varfërisë, SIDA-s, shuarjen e urisë dhe zhdukjen e diskriminimit ndaj grave dhe vajzave. Të gjithë vendet duhet të jenë të gatshme për të arritur këto objektiva ambicioze.

Ndjekja dhe arritja e Agjendës 2030 nuk bazohet gjithmonë në statistika zyrtare. Mungesa e aftësisë për të siguruar statistika zyrtare për shkak të fondeve, burimeve njerëzore do të çojë në mungesë të cilësisë së statistikave për prodhimin e treguesve të OZHQ-ve. Duhet të ndërmerren veprime në secilin nga vendet e angazhuara për të siguruar përdorimin më të mirë të fondeve dhe burimeve ekzistuese, si dhe burimeve shtesë.

Gjithashtu, vendet duhet të hartojnë plane veprimi me afate të përcaktuara që identifikojnë dhe vlerësojnë nevojat për prodhimin e treguesve statistikorë për OZHQ-të. Duke marrë parasysh gamën e gjerë të treguesve dhe larminë e tyre, kombëtarizimi i indikatorëve do të jetë



një hap thelbësor që duhet të merret për të caktuar përparësitë dhe punën për arritjen e Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Grupi Drejtues i Konferencës së Statisticienëve Evropianë, i Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën, rekomandon që Institutet Statistikore Kombëtare të luajnë rolin kryesor koordinues në sigurimin e statistikave për monitorimin e OZHQ-ve, duke bashkëpunuar ngushtë me çdo organ kombëtar përgjegjës për OZHQ-të.

Nga lista e 244 treguesve globalë që shërbejnë për monitorimin e OZHQ-ve, nga vlerësimet paraprake rezulton se në Shqipëri monitorohen 83 tregues që prodhohen nga INSTAT apo institucione të tjera. Në kuadër

të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI III, 2023-2024, fokus i vecantë do t'i jepet harmonizimit të SKZHI III me OZHQ-të, për ato tregues globalë të OZHQ-ve që monitorohen në vendin tonë, si pjesë e treguesve të monitorimit të vetë SKZHI III.

INSTAT, ndërkohë, ka në planet e tij të punës vlerësimin e indikatorëve që mund të prodhohen me anketat apo burimet ekzistuese, si dhe po sheh mundësitë për shtim modulesh në anketat ekzistuese për të rritur numrin e indikatorëve të OZHQ-ve. Gjithashtu, me përfundimin dhe botimin e anketës së re "Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ)" INSTAT realizoi prodhimin e indikatorëve të rinj në linjë me metodologjinë e Kombeve të Bashkuara.

## REFERENCA

- [1] Raporti Vullnetar i Shqipërisë në Forumin e Nivelit të Lartë Politik Nju Jork, 2018;  
[https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA\\_VNR\\_2018\\_FINAL2.pdf](https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/20257ALBANIA_VNR_2018_FINAL2.pdf)
- [2] Raporti i Harmonizimit të OZHQ-ve me Politikat Sektoriale të Shqipërisë;  
<https://www.un.org.al/sites/default/files/Albania%20Report%20on%20the%20Harmonization.pdf>
- [3] Raporti final i UNDP mbi Pilotin e Objektivit 16 Fq 11;  
<https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/final-report-on-illustrative-work-to-pilot-governance-in-the-con.html>
- [4] Udhërrëfyesi i UNECE për OZHQ-të;  
<https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2017/ECECESSTAT20172.pdf>

# SISTEMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR PESHKIMIN NË SHQIPËRI

Denis Kristo, Instituti i Statistikave  
dkristo@instat.gov.al

MSc. Marco Kule, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
marcokule11@gmail.com

## Abstrakt

Mbledhja e të dhënave është procesi kryesor për përfundimin e informacioneve të nevojshme lidhur me peshkimin. Mbledhja e të dhënave sipas standardeve të Bashkimit Evropian, mundëson analizimin e tyre dhe hartimin e politikave të menaxhimit të aktivitetit të peshkimit në det. Mbledhja e të dhënave në Shqipëri kryhet në përputhje me detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat e peshkimit mblidhen nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke u mbështetur në metodikën e GFCM (Komisioni i Përgjithshëm për Peshkimin në Mesdhe) për grumbullimin e të dhënave bazuar në segmentet e flotës së peshkimit, grumbullimin e logbook-eve nga anijet, intervistat me operatorët e akuakulturës, etj. Të dhënat për zënien e peshkut grumbullohen sipas kategorive ujore dhe në nivel vendi. Qëllimi i këtij artikulli është të japë një shpjegim mbi metodologjinë e mbledhjes së të dhënave lidhur me peshkimin deri në publikimin e tyre.

## Fjalë kyçe:

Mbledhja e të dhënave; Peshkimi; Flota; Zënie; DCRF-GFCM

### 1. HYRJE

Shqipëria mbledh dhe raporton të dhëna në lidhje me peshkimin bazuar në detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shqipëria, si vend anëtar i Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit, me ratifikimin e marrëveshjes së krijimit të këtij Komisioni me ligjin nr. Nr. 9093, datë 3.7.2003 “Për ratifikimin e Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, grumbullon të dhënat e mbledhura për sektorin e peshkimit dhe i raporton pranë këtij Komisioni sipas afateve të përcaktuara.

Gjithashtu, të dhënat mbledhen bazuar edhe në legjislacioni kombëtar, Ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar (Kreu XII, Grumbullimi, menaxhimi dhe përdorimi i të dhënave) si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 256/2019 “Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit”. Ky vendim është përaftrim i Rregullores (EU) 2017/1004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 maj 2017 për krijimin e një kornize të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) 199/2008 të Këshillit dhe Vendimit për zbatim të Komisionit (EU) 2016/1251, i 12 korrikut 2016 për miratimin e një programi shumëvjeçar të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës për periudhën 2017-2019.

Në të dyja rastet, të dhënat e mbledhura janë të ngjashme, duke qenë se është grumbullimi i të dhënave në kuadër të GFCM (Komisioni i Përgjithshëm për Peshkimin në Mesdhe) më i përgjithshëm dhe i thjeshtuar kundrejt bazës ligjore të BE-së. Në GFCM bëjnë pjesë, përveç vendeve Evropiane të BE-së ose jo, që lagen nga deti Mesdhe, edhe vendet e Afrikës Veriore të këtij deti. Në këto kushte, detyrimet e BE-së nuk mund të aplikohen nga vendet e Afrikës Veriore të cilat nuk kanë asnjë detyrim, sot dhe në të ardhmen, kundrejt Bashkimit Evropian.

Shqipëria, si vend kandidat i BE-së, ka detyrimin e përaftrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së dhe natyrisht edhe mbledhja e të dhënave të saj duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Në këtë artikull do të shpjegohen të dhënat që mbledhen në Shqipëri, duke u përqendruar tek metodologjitë e miratuara.

### KORNIZA REFERUESE PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE DHE KOMISIONI I PËRGJITHSHËM PËR PESHKIMIN NË MESDHE

DCRF është korniza e parë e përgjithshme e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, ndërsa GFCM për mbledhjen dhe dorëzimin e të dhënave të lidhura me peshkimin, kërkuar sipas Rekomandimeve ekzistuese të GFCM.

DCRF është e nevojshme për organet përkatëse ndihmëse të GFCM për të formuluar këshilla në përputhje me objektivat e tyre.

DCRF është një instrument i GFCM, krijuar nga organet teknike ndihmëse, përgjegjëse për këshillimin shkencor si një përgjigje konkrete ndaj nevojës për të përforcuar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mbi peshkimin, në zonën e zbatimit të GFCM (Mesdheu dhe Deti i Zi). DCRF synon të jetë instrumenti kyç në arritjen e një programi më efikas për mbledhjen e të dhënave në të gjithë rajonin dhe për një integrim më mirë midis mbledhjes së të dhënave dhe planet nënrajonale shumëvjeçare të menaxhimit. DCRF duhet të rishikohet rregullisht nga organet ndihmëse të GFCM për të zbardhur kërkesat.

### 3. KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË DCRF

DCRF synon optimizimin e mbledhjes së të dhënave të peshkimit të GFCM përmes:

- identifikimit të qartë të fushave kryesore tematike të grumbullimit të të dhënave (të përcaktuara si “detyra”) së bashku me përcaktimin e qëllimeve të tyre në përputhje me objektivin e GFCM;
- përshkrimit të detajuar të të gjithë variablave të të dhënave;
- thjeshtësimit në kategorizimin e të dhënave për variablat e kërkuara;
- skemave më të thjeshta dhe fleksibël për segmentimin e flotës;
- masave të thjeshtësuara për sforcën e peshkimit e

cila sipas kornizës referuese për grumbullimin e të dhënave për peshkimin është një mënyrë matjeje e aktivitetit të peshkimit e shprehur si prodhimi (shumëzimi) i një numri parametrash të lidhura me kapacitetin e anijes së peshkimit dhe veglave të peshkimit, të përdorura në një zonë peshkimi në një njësi të caktuar kohe. Për shembull orë tralimi (tërheqje trate në ditë, i një numri grepash të vendosur në ditë apo numër rrethimesh me tratë zalli në një ditë);

- konceptit të ri në grupimin e llojeve prioritare, ku speciet identifikohen në nivel të pesë nënrajoneve të GFCM (Deti Mesdhe Perëndimor, Deti Mesdhe, Deti Adriatik, Deti Mesdhe Lindor dhe Deti i Zi);
- praktikave të mirëpërcaktuara për mbledhjen e të dhënave;
- procedurave të përmirësuara për paraqitjen e të dhënave online.

### 4. PSE NEVOJITET DCRF?

GFCM ka përgjegjësinë dhe autoritetin për të mbikëqyrur procesin e plotë të menaxhimit të peshkimit, të ndërmarrë vlerësime shkencore dhe të marrë vendime për të siguruar qëndrueshmërinë e burimeve të peshkimit në fushën e saj të aplikimit. Mbledhja e të dhënave është vendimtare për të arritur një menaxhim të duhur të peshkimit dhe vendet pranuese duhet të sigurojnë informacionin më të mirë që kanë në dispozicion, në aspektin e cilësisë dhe të gjithë përfshirjes.

Nevoja për të krijuar një sistem funksional të mbledhjes së të dhënave në zonën e aplikimit të GFCM ka qenë gjithmonë një çështje kyçe. Janë bërë shumë përpjekje për të zhvilluar mjete të dobishme për krijimin e sistemeve të informacionit të GFCM, bankat e të dhënave përkatëse dhe protokollet të lidhura për dorëzimin e të dhënave (p.sh. - Rekomandimi GFCM / 33/2009/3). Sidoqoftë, pavarësisht hapave të ndërmarrë nga viti 2010 për të inkurajuar dhe mbështetur vendet anëtare për të paraqitur të dhëna, niveli i pajtueshmërisë ende duhet të përmirësohet. Shumë prej grupeve të të dhënave janë pranuar në një gjendje jo të plotë, duke penguar kështu aftësinë e GFCM për të përdorur këto të dhëna për të përmbushur objektivat e saj.

Arsyeja e hartimit të kësaj kornize është zvogëlimi i kritereve lidhur me të dhënat dhe përfshirja e tyre në një

manual të vetëm, të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kuptuar, duke u siguruar vendeve anëtare indikacionet e nevojshme për mbledhjen dhe transmetimin e të dhënave në lidhje me peshkimin në Sekretariatit e GFCM. Për më tepër, informacioni i mbledhur duhet të jetë i mjaftueshëm dhe i besueshëm për të shqyrtuar statusin e burimeve të ndryshme, për të vlerësuar dimensionet ekonomike dhe sociale të flotës dhe për të ofruar këshilla shkencore mbi statusin e burimeve, si dhe për të lejuar vendet anëtare të përgatisin rekomandimet për t'i menaxhuar ato.

Për të përmbushur objektivat e GFCM, të dhënat e mbledhura nga DCRF përfshijnë informacionin mbi flotat kombëtare, zonat dhe aktivitetet e tyre, zëniet dhe sforcon dhe informacionin biologjik mbi speciet kryesore, duke përfshirë edhe zëniet e rastësishme të specieve të rrezikuara. Gjithashtu, për të vlerësuar gjendjen ekonomike të ndërmarrjeve të peshkimit dhe tendencat e punësimit, të nevojshme janë edhe të dhënat socio-ekonomike. Sipas DCRF-së, vendet anëtare duhet të garantojnë cilësinë dhe plotësinë e të dhënave sipas kategorive të kërkuar dhe, sipas një formati të përcaktuar, t'i dërgojnë ato në kohën e duhur tek Sekretariati i GFCM.

#### DCRF bazohet në 7 “detyra” kryesore:

- T1 – Përshkrimi i detajuar i peshkimit kombëtar
- T2 – Zëniet (të dhëna mbi zbarkimet, zëniet për specie)
- T3 - Zëniet aksidentale të specieve në rrezik
- T4 – Flota
- T5 - Sforco
- T6 - Faktorët socio-ekonomikë
- T7 - Të dhënat biologjike (vlerësimi i stokut, të dhëna mbi gjatësinë, të dhëna të tjera biologjike, ngjala evropiane, indikatorët mjedisorë).

#### Struktura e secilës detyrë të DCRF është:

- Përshkrimi
- Shtetet e përfshira
- Të dhënat (të detyrueshme/fakultative)
- Konfidencialiteti
- Frekuenca dhe afati i transmetimit

## SISTEMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR PESHKIMIN NË SHQIPËRI

Tabela 1: Detyrat e GFCM-DCRF, të dhënat dhe qëllimet

ID	DETYRA	NËNDETYRA	TË DHËNAT	QËLLIMI
T. I	Përshkrimi i detajuar i peshkimit kombëtar	-	Të dhënat vjetore mbi zbarkimet totale, numrin e anijeve, kapacitetin total dhe fuqinë totale të motorit sipas shteteve.	Vështrim i përgjithshëm i peshkimit në secilin shtet lidhur me treguesit e kapacitetit dhe zbarkimet totale, të cilat sipas kornizës referuese për grumbullimin e të dhënave për peshkimin janë pjesa e zënies e mbajtur në bord dhe e sjellë në port.
T. II	Zëniet	II.1) Të dhënat mbi zbarkimet	Të dhënat vjetore mbi zëniet totale kombëtare (zbarkimet) sipas vendit, zonës dhe segmentit të flotës.	Monitorimi i biomasës totale vjetore të zbarkuar nga vendit, zona dhe segmenti i flotës i cili sipas kornizës referuese për grumbullimin e të dhënave për peshkimin është kombinimi i një grupi anijesh me madhësi të njëjtë, që përdorin të njëjtën vegël peshkimi për më shumë se 50 për qind të kohës në det, gjatë një viti.
		II.2) Zëniet për specie	Të dhënat vjetore mbi zëniet totale (zbarkimet dhe hedhurinat) për speciet kryesore komerciale, të raportuara sipas vendit, zonës dhe segmentit të flotës.	Monitorimi i trendit të zënieve totale (zbarkimet dhe hedhurinat) të llojeve kryesore tregtare.
T. III	Zëniet aksidentale të specieve në rrezik	-	Të dhënat vjetore (Numri i individëve) mbi zëniet aksidentale të llojeve të rrezikuara (shpend, breshka, gjitarë detarë dhe lloje peshkaqenësh) sipas vendit, zonës, dhe mjeteve të peshkimit.	Përcaktimi i zënieve të rastësishme të specieve të rrezikuara sipas segmentit të flotës dhe vlerësimi i ndikimit të peshkimit në këto specie.
T. IV	Flota	-	Regjistrimi i anijeve të peshkimit me të dhënat identifikuese (Emri i anijes, numri ID, porti, mjete i peshkimit, nënrajoni gjeografike etj.) dhe informacionet mbi karakteristikat teknike (tonazhi bruto, fuqia motorike, gjatësia e përgjithshme etj.) flotës që veprojnë në zonën e aplikimit të GFCM.	Monitorimi i kapacitetit të peshkimit në zonën e aplikimit të GFCM.
T. V	Sforco	-	Të dhënat mbi sforcon e peshkimit llogariten si një kombinim i kapacitetit dhe aktivizimit, sipas vendit, zonës, segmentit të flotës dhe mjeteve të peshkimit. Informacion mbi zëniet për njësi të sforcos (CPUE) për specie kryesore komerciale.	Përlllogaritja e sasisë së sforcos, vlerësimi i presionit nga peshkimi dhe tendencat në CPUE.
T. VI	Faktorët socio-ekonomikë	-	Të dhënat e lidhura me variablat ekonomikë dhe socialë të peshkimit sipas vendit, zonës dhe segmentit të flotës.	Vlerësimi i vlerës ekonomike dhe implikimet sociale të peshkimit.
T. VII	Informacioni Biologjik	VII.1) Vlerësimi i stokut	Të dhënat vjetore për identifikimin e stokut dhe informacione biologjike mbi stokun për speciet prioritare: parametrat e rritjes, marrëdhëniet, gjatësia / pesha, rekrutimi, biomasa. Informacion mbi faktorët e mjedisit që mund të ndikojnë në dinamikën e popullsisë.	Vlerësimi i gjendjes së stokeve dhe sigurimi i këshillave shkencore.
		VII.2) Te dhëna mbi gjatësinë	Të dhënat në lidhje me shpërndarjen e gjatësisë, në zbarkime, të specieve të identifikuar si prioritare për zonën dhe segmentin e flotës.	Monitorimi i strukturës së popullatave të ekspozuara.
		VII.3) Të dhëna të tjera biologjike	Informacion mbi disa variabla biologjike (gjinia dhe pjekuria) e specieve prioritare, për zonën dhe segmentin e flotës.	Monitorimi i normave dhe dinamikave biologjike të specieve të shfrytëzuara.
		VII.6) Ngjala evropiane	Të dhënat vjetore mbi zëniet totale, llojet e mjeteve dhe ditët e peshkimit, sipas vendit dhe fazës së jetës.	Monitorimi i statusit të ngjalës evropiane
		VII.7) Indikatorët mjedisorë	Treguesit e përbashkët të përzgjedhur do t'i referohen biomasës së rekruteve, zbarkimet totale, mortaliteti nga peshkimi, sforco dhe zëniet e rastësishme të specieve të ndieshme dhe jo-objekt peshkimi	Monitorimi i ndikimit të aktiviteteve të peshkimit në burimet iktike të shfrytëzuara.

## Detyra II: Zëniet

Zëniet, sipas kornizës referuese për grumbullimin e të dhënave për peshkimin, janë sasia e burimeve biologjike detare të kapura nga vegla e peshkimit që arrin në kuvertën e anijes së peshkimit. Këtu përfshihen individët e specieve të synuara, të cilat zakonisht mbahen në bord dhe ruhen, dhe ato by-catch, të cilat i referohen kapjes së llojeve që nuk janë në objekt peshkimi, me ose pa vlerë komerciale. Njohja e biomasës së larguar nga ekosistemi, nga aktiviteti i peshkimit, është thelbësore për të monitoruar statusin e stokeve, si dhe ndikimin e peshkimit në popullatat peshkore.


### Nëndetyra II.1: Të dhëna mbi zbarkimet

Kjo detyrë i referohet sasisë totale të peshkut të zbarkuar. Sasia e përgjithshme e të gjitha specieve të zbarkuara, në njësi peshë (ton) sipas segmentit të flotës, së bashku me numrin e përgjithshëm të anijeve, duhet të raportohet sipas shtetit dhe zonës (GSA). Shifrat totale të zbarkimeve mund të merren nga burime të ndryshme, si për shembull log-book, të dhëna mbi shitjet, kampionimi dhe intervistat.

### Nëndetyra II.2: Të dhënat mbi zëniet sipas specieve

Për speciet kryesore tregtare, të identifikuar në nivelin kombëtar, shtetet duhet të paraqesin informacione mbi zëniet totale sipas zonës (GSA) dhe segmentit të flotës. Zëniet totale duhet të konsiderohet si pesha (në ton) e zënieve totale vjetore, duke përfshirë zbarkimet (ulje) dhe fraksionin e hedhur (hedhurinat).

Figura 1: Skema paraqet përbërësit e ndryshëm të zënies



Individët e të njëjtës specie mund të lëvizin nga një kategori, tregtare ose hedhurina, në një tjetër, lidhur kjo nga madhësia, kërkesat e tregut, sezoni ose kritere të tjera. Në mënyrë të ngjashme, speciet e tjera mund të jenë të padëshirueshme ose me një vlerë të ulët, në një nënrajon, kundrejt një nënrajonit tjetër, siç paraqitet në figurën 1.

## Detyra IV: Flota

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj detyre është të sigurojë informacione mbi flotën që vepron në zonën e aplikimit të GFCM, në mënyrë që të plotësohen statistika të besueshme mbi kapacitetin e flotës, për qëllime menaxhimi në nivelin rajonal dhe nënrajon.

Secili shtet duhet të paraqesë informacione mbi flotën kombëtare, anijet ose mjetet lundruese artizanale që janë të pajisura dhe përdoren për peshkim tregtar në zonën e aplikimit të GFCM. Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet mjeteve lundruese artizanale.

Të dhënat e mbledhura në këtë detyrë do të mundësojnë:

- një burim statistikash të sakta për flotën e peshkimit në Mesdhe;
- një panoramë të plotë të kapacitetit rajonal, nënrajon dhe kombëtar të peshkimit;
- njohuri më të mira në nivelin rajonal/ nënrajon të moshës së flotave (treguesi i sigurisë);
- ngjarjet historike: hyrjet dhe daljet nga flota, modifikimet dhe karakteristikat.

Të dhënat e nevojshme për këtë detyrë mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Administrative (emri, porti, numri i regjistrimit, etj.)
- Teknike (gjatësia, tonazhi, fuqia, vegla e peshkimit etj.)
- Personeli (operatorët, ekuipazhi etj.)

Vendimi i Këshillit të Ministrave 256/2019 “Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit” ka për qëllim detajimin e kapitullit XII të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin” i ndryshuar, në lidhje me

mblidhen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në peshkim. Shqipëria raporton të dhënat në mënyrë periodike në GFCM, sikurse është e përfshirë në programet ndërkombëtare të grumbullimit të të dhënave. Të dhënat që mblidhen nën GFCM janë me format të ngjashëm me të dhënat e mblidhura nga BE dhe shkalla e përputhshmërisë së mblledhjes dhe përpunimit të tyre është një nga çështjet që diskutohet. Gjithashtu, BE kërkon të dhënat e mblidhura nga Shqipëria, edhe pse jo në formë të detyrueshme, me qëllim përpunimin e tyre, duke qenë se pjesa më e madhe e detit Adriatik është det i brendshëm i BE-së.

Për këtë qëllim, edhe formati i të dhënave që duhet të mblidhen nga Shqipëria duhet të jetë në përputhje me ato të BE-së. Burimet e peshkimit në det janë të bashkëndara (shared stocks) dhe në këtë kontekst analizimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të përbashkët me vendet e tjera të cilat shfrytëzojnë këto burime. Të dhënat e mblidhura nga Italia, Kroacia dhe Slovenia, si vende anëtare të BE-së, sikurse dhe të dhënat e mblidhura nga Mali i Zi, vend i cili ka çelur negociatat, janë të njehsuara. Për këtë qëllim, edhe të dhënat që duhet të mblidhen nga Shqipëria duhet të jenë në përputhje me të dhënat e mblidhura dhe përpunuara nga BE.

Ky vendim miraton programin e kampionit shumëvjeçar sipas detyrimeve të përcaktuara në anekset e tij.

## 5. MBLEDHJA, MENAXHIMI DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE NË PESHKIM

Mbledhja e të dhënave është procesi kryesor për përfundimin e informacioneve të nevojshme lidhur me peshkimin. Mbledhja e të dhënave sipas standardeve të BE-së mundëson analizimin e tyre dhe hartimin e politikave të menaxhimit të aktivitetit të peshkimit në det. Informacioni kryesor për potencialin e flotës së peshkimit të një vendi, përftohet nga të dhënat mbi zëniet vjetore dhe përbërja e flotës.

Për sa i përket të dhënave mbi zëniet nga viti 2012, me hyrjen në fuqi të ligjit 64 "Për Peshkimin" të gjitha mjetet me gjatësi mbi 10 metra janë të detyruar të dorëzojnë pranë Inspektoratit të Peshkimit, logbook-et e plotësuar me informacionet e kërkuara. Përpara vitit 2012 zëniet janë përlogaritur nga deklaratimet vullnetare të peshkatarëve dhe si të tilla janë pak të besueshme.

Pas grumbullimit të logbook-ve, ato numërohen, rakordohen me daljet e regjistruara nga autoriteti portual dhe të dhënat

mbi zëniet, sipas specieve, hidhen në një bazë të dhënash të posaçme. Evidencat nga logbook-et transmetohen nga Inspektorati i Peshkimit dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe më pas në INSTAT çdo 3 muaj. Për secilin 3-mujor transmetohen vetëm zëniet totale të kryera në atë periudhë; zëniet sipas specieve transmetohen vetëm në fund të vitit, bashkë me zëniet totale vjetore.

Figura 2: Shembull i një prej logbook-ve




Figura 3: Zëniet sipas specieve

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	W	X	Y	Z	AA	AB	AC	AD	AE	AF	AG	AH	AI	AJ					
178	ROMANIA 13	560	280	80			20				150	20																													
179		400	200	40							80																														
180		400	200	10							20																														
181		500	250	80			40				180	20																													
182		500	250	30							100																														
183	TOTALI	2400	1200	230	0	0	40	0	0	0	630	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		
184	ROMANIA 14	800	300	130			30				180	20																													
185		800	300	10							100																														
186		800	300	10							100																														
187		900	300	80							140	20																													
188	TOTALI	1400	500	240	0	0	30	0	0	0	490	20	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0			
189	ROMANIA 15			100	50						100	20																													
190				100	50						100	20																													
191				100	50						100	20																													
192				100	50						100	20																													
193				100	50						100	20																													
194				100	50						100	20																													
195				100	50						100	20																													
196				100	50						100	20																													
197				100	50						100	20																													
198				100	50						100	20																													
199				100	50						100	20																													

Siç paraqitet më sipër, të dhënat e para vitit 2012 kishin shumë mangësi pasi ishin rezultat i deklarimeve vullnetare të subjekteve. Ky fakt detyroi Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të hartonte një metodikë për rindërtimin e këtyre të dhënave, në mënyrë që zëniet ndër vite të ndjekin të njëjtin trend, dhe gjithashtu të jenë sa më afër realitetit. Kjo diferencë nuk është si pasojë e rritjes së sforcos së peshkimit, por lidhet me informacionin e paktë mbi zëniet e mblidhura gjatë asaj periudhe dhe si rezultat i shkallës së lartë të informalitetit që ka ekzistuar në peshkim. Rindërtimi i të dhënave ka të bëjë me peshkimin detar i cili, falë edhe skemës së mbështetjes me karburant pa taksa, është aktualisht më i formalizuar. Peshkimi detar është në të njëjtën kohë edhe elementi më i rëndësishëm ekonomik i peshkimit.



Legjislacioni në fuqi lidh furnizimin me karburant pa akcizë me deklarimin e prodhimit me faturë tatimore me TVSH. Anijet e peshkimit rakordojnë një herë në gjashtë muaj me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vlerën e karburantit me të cilin janë furnizuar dhe vlerën e faturave tatimore të peshkut të shitur (VKM nr. 612/2012, i ndryshuar dhe VKM 29/2015). Gjithashtu, bazuar në pikën 28 të Udhëzimit nr. 18/2015, në rast se anijet e peshkimit nuk dorëzojnë logbook-et përjashtohen nga furnizimi me karburant pa akcizë. Logbook-et duhet të përputhen me faturat e peshkut të shitur me TVSH.

Një nga mënyrat e propozuara nga ekspertët e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është rindërtimi i zënieve, duke përdorur si bazë sforcon aktuale të peshkimit.

### Kjo metodikë konsiston në këto etapa:

1. Përzgjedhja e viteve kur besohet se të dhënat mbi zëniet janë më të sakta dhe të besueshme (vitet 2016-2019)
2. Përlllogaritja e sforcos së peshkimit (ton/vit) për secilin mjet peshkimi sipas segmenteve të flotës, për vitet e zgjedhura
3. Përlllogaritja e mesatares së sforcos për vitet e zgjedhura
4. Informacioni mbi flotën kombëtare për periudhën përpara 2012-ës (numri total i mjeteve të peshkimit dhe sipas segmentit të flotës)
5. Shumëzimi i sforcos të përlllogaritur sipas segmenteve të flotës, me numrin e mjeteve të peshkimit ndër vite
6. Me anë të këtij shumëzimi do të përlllogariten zëniet ndër vite për periudhën përpara 2012
7. Për të përlllogaritur zëniet për specie do të ndiqet një procedurë e ngjashme, ku për bazë do të merren proporcionet, pra përqindja, që zë secila specie në zëniet totale vjetore për periudhën e përzgjedhur;
8. Kjo procedurë do të kryhet vetëm për speciet kryesore tregtare të specifikuara në DCRF dhe me rendësi në vendin tonë
9. Kjo metodikë mund të jetë e vështirë për t'u realizuar, për mungesën e informacionit të saktë mbi flotën kombëtare përparuar 2010 (përpara këtij viti

nuk ishte në përdorim softwari i regjistrit kombëtar të anijeve të peshkimit)

Për shkak të vështirësisë në realizimin e metodikës së parë, është menduar një metodikë alternative më e lehtë që do të bashkëngjitet së parës që konsiston në përlllogaritjen e përqindjes që zënë zëniet e flotës shqiptare ndaj zënieve të shteteve të tjera në Adriatik me qëllim kryqëzimin e informacionit.

Informacioni mbi zëniet totale dhe sipas specieve për shtetet e Mesdheut, gjenden në bazën e të dhënave të GFCM. Ky informacion mund të përdoret për rindërtimin e zënieve sipas specieve:

1. Përlllogaritet përqindja që zë një specie, ndaj totalit të zënieve (për atë specie) të shteteve të tjera në Adriatik, duke marrë si reference periudhën 2012-2018
2. Përqindja e përfutur do të shumëzohet me totalin e zënieve, për atë specie, të vendeve të tjera të Adriatikut.
3. Rezultati do të jenë zëniet e flotës kombëtare për specien e përzgjedhur
4. Kjo procedurë do të ndiqet edhe për rindërtimin e zënieve të specieve të tjera tregtare të specifikuara në DCRF dhe me rendësi në vendin tonë

Transmetimi i të dhënave mbi zëniet vjetore dhe sipas specieve kryhet një herë në vit në DCRF dhe GFCM.


Tabela 2 paraqet zëniet sipas specieve kryesore për një periudhë 5-vjeçare. Në vitin 2018, për sa i përket kategorive ujore detare, bregdetare dhe lagunore, specia e cila ka rezultuar me përqindjen më të madhe të zënës është "Açuga" me 24,4 % ndaj totalit, pasuar nga "Karkaleci i thellësisë" me 20,6 % dhe "Merluci" me 14,1 %.

**Tabela 2: Zëniet sipas specieve kryesore (viti 2014-2018)**

Specie	2014	2015	2016	2017	2018
Karkaleci roze i thellësisë	1430	1290	1460	1473	1275
Açuge	1236	250	280	320	1516
Merluc	902	914	948	940	872
Sardele	1106	1200	890	1065	460
Skampi	400	405	411	389	257
Barbun	380	466	475	470	347

Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

**Grafiku 1: Zëniet sipas specieve kryesore (viti 2014-2018)**



Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018


Tabela 3 paraqet zëniet gjithsej për një periudhë 5-vjeçare. Nga të dhënat për vitin e fundit, zëniet gjithsej kanë pësuar një rënie afërsisht 1%.

**Tabela 3: Zëniet gjithsej (viti 2014-2018)**

Viti	2014	2015	2016	2017	2018
Zëniet totale (t)	7059	6216	6196	6282	6202

Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

**Grafiku 2: Zëniet gjithsej (viti 2014-2018)**



Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

Në lidhje me të dhënat mbi flotën kombëtare, i gjithë informacioni gjendet në regjistrin kombëtar i anijeve të peshkimit, i cili përditësohet në mënyrë periodike duke shtuar mjetet e reja në flotën kombëtare. Regjistri përbehet nga një software në të cilin vendosen të gjitha informacionet për një mjet peshkimi. Burimi i këtyre informacioneve janë lejet e peshkimit si dhe të dhënat nga Regjistri i mjeteve Lundruese të Anijeve i RSH dhe me pas vendosen në softwar-in e regjistrin kombëtar të anijeve.

Informacionet në regjistrin kombëtar të anijeve grupohen në:

- Karakteristikat e përgjithshme të anijes
- Karakteristika strukturore
- Autorizimet
- Karakteristika mbi veglën e peshkimit të përdorur
- Karakteristika e motorit
- Pajisjet elektrike në bord
- Pajisjet dhe makineritë e tjera në bord
- Të dhëna mbi pronësinë
- Të dhëna mbi ekuipazhin.


Tabela 4 paraqet përbërjen e flotës për një periudhë 5-vjeçare. Flota detare shqiptare nisur nga qëllimi i anijeve ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi. Për vitin 2018, pjesa më e madhe e flotës sonë është e përbërë nga anije me njica (67,0 %) si dhe anije peshkimi me tërheqje (fundore dhe pelagjike) me 27,0 %, të cilat përdoret kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë. Pjesa tjetër janë anije shumëpërdorimshme dhe anije për qëllime të tjera.

**Tabela 4: Përbërja e flotës (viti 2014-2018)**

Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Shpërndarja e flotës sipas llojit të anijes</b>					
Me tërheqje (fundore)	166	156	156	157	170
Me koshilok	13	11	11	13	12
Me draga hidraulike	0	5	5	5	5
Me njica	389	367	368	360	424
Anije shumëpërdorimshme	13	25	25	24	22
<b>Gjithsej</b>	<b>581</b>	<b>564</b>	<b>565</b>	<b>559</b>	<b>633</b>

Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

**Grafiku 3: Përbërja e flotës (viti 2014-2018)**



Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

Tabela 5 paraqet shpërndarjen e flotës sipas porteve për një periudhë 5-vjeçare. Në vitin 2018, porti me numrin më të madh të anijeve të liçencuara ishte porti i Durrësit, me 37,0 % të flotës së përgjithshme. Porti i Vlorës ka 31,0 % të numrit të përgjithshëm të flotës, pasuar nga porti i Sarandës me 16,0 %.


Portet e peshkimit të Himarës dhe Lushnje-Fier janë ato me përqindjet më të vogla të subjekteve të liçencuara për peshkim, përkatësisht me nga 2,0 %.

**Tabela 5: Shpërndarja e flotës sipas porteve (viti 2014-2018)**

Emërtimi	2014	2015	2016	2017	2018
<b>Shpërndarja e flotës sipas porteve</b>					
Durrës	219	209	209	204	233
Vlorë	210	183	184	181	198
Saranda	91	86	86	84	99
Shëngjin	52	65	65	73	78
Himara	4	11	11	10	12
Lushnje -Fier	5	10	10	7	12
<b>Gjithsej</b>	<b>581</b>	<b>564</b>	<b>565</b>	<b>559</b>	<b>632</b>

Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

**Grafiku 4: Shpërndarja e flotës sipas porteve (viti 2014-2018)**



Burimi: Instituti i Statistikave, Statistikat e Peshkimit 2018

## 6. KONKLUZIONE

Për shkak të vështirësisë në realizimin e metodikës së parë për përlogaritjen e të dhënave, është menduar një metodikë alternative më e lehtë që do t'i bashkëngjitet së parës që konsiston në përlogaritjen e përqindjes që zënë zëniet e flotës shqiptare ndaj zënieve të shteteve të tjera në Adriatik me qëllim kryqëzimin e informacionit.

Gjatë vitit 2018, nga të dhënat e raportuara në lidhje me zëniet, ka pasur një ulje të zënieve detare me rreth 12,1 % krahasuar me vitin 2014. Ndikimin më të madh në këtë ulje e kanë reflektuar sardelet me një rënie prej 58,4 %.

Për sa i përket kategorive ujore detare, bregdetare dhe lagunore, specia e cila ka rezultuar me përqindjen më të madhe të zënë është "Açuga" me 24,4 % ndaj totalit, pasuar nga "Karkaleci i thellësisë" me 20,6 % dhe "Merluci" me 14,1 %.

Flota detare shqiptare, për vitin 2018, ka pësuar një rritje të numrit të saj me rreth 8,8 % krahasuar me vitin 2014. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë anijet me njica me një rritje prej 9,0 %.

Nisur nga qëllimi, flota ndahet në gjashtë lloje të ndryshme anije peshkimi. Pjesa më e madhe e flotës sonë është e përbërë nga anije me njica (67,0 %) si dhe anije peshkimi me tërheqje (fundore dhe pelagjike) me 27,0 %, të cilat përdoren kryesisht për të peshkuar peshqit fundorë. Pjesa tjetër janë anije shumëpërdorimëshe dhe anije për qëllime të tjera. Shqipëria, si vend kandidat i BE-së, ka detyrimin e përafrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së dhe natyrisht edhe mbledhja e të dhënave të saj duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së. Informacioni në lidhje me statistikën e peshkimit ndihmon shtetet anëtare të shqyrtojnë statusin e burimeve të ndryshme në dispozicion, të vlerësojnë dimensionet ekonomike dhe sociale të flotës dhe të ofrojnë këshilla shkencore mbi statusin e burimeve. Ky informacion i ofron Shqipërisë një pasqyrë të plotë të situatës dhe i lejon që të evidentojë rekomandimet për të menaxhuar sa më mirë këto burime.

### REFERENCA

- [1] General Fisheries Commission for the Mediterranean (GFCM), (2018) and Data Collection Reference Framework (DCRF). Version: 19.1
- [2] INSTAT, Statistikat e Peshkimit, 2018  
<http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/peshkimi/>
- [3] Ligji nr. 64/2012 “Për peshkimin” i ndryshuar  
[http://www.mod.gov.al/images/akteligjore/qnod/01\\_Ligj\\_64\\_2012\\_peshkimi\\_ndryshuar.pdf](http://www.mod.gov.al/images/akteligjore/qnod/01_Ligj_64_2012_peshkimi_ndryshuar.pdf)
- [4] VKM 256/2019 “Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit”